

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

8SH-32

g. 13

ALI D.  
JASIQI

TREGIME

SHENJE  
NË LIS

8 SH-32  
J 13

ALI D. JASIQI

# SHENJË NË LIS

tregime

1213



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

**Redaktor: TATJANA HAXHIMIHALI**

Përbledhja me tregime «Shenjë në lis» e shkrimtarit shqiptar nga Juniku i Gjakovës Ali D. Jasiqi është botuar në Prishtinë në vitin 1974.

Shkrimet trajtojnë një problematikë morale e shoqërore, pasqyrojnë aspekte nga jeta e njerëzve të atyre trevave. Këto tregime janë shkruar me një gjuhë të qartë e të rrjedhshme në formën tradicionale të tregimit realist. Nëpërmjet ngjarjeve, në dukje të zakonshme, gjen fakte e dukuri të veçanta që zgjojnë emocione karakteristike, që pohojnë idenë e dashurisë për njeriun e thjeshtë të popullit. dhe zbulojnë botën e brendshme e synimin fisnik të tij për t'u çliruar nga pranga mentalitetesh e paragjykimisht të vjetra patriarkale.

## AI ISHTE NXËNËSI I TIJ

Kur hyri profesori, ky nuk e vërejti fare. Rrinte ulur në bankën e parë të rendit nga dera dhe disi, pa kurrfarë lidhjeje e qëllimi, bënte disa viza në një kënd të gazetës me të cilën kishte mbështjellë fletoren e shënimeve. Rroku lapsin me gishtin e madh dhe atë tregues të dorës së djathtë dhe, pasi nyjen e atij të mesmit e vuri mbi gazetë duke i rënduar, e solli fletoren me dorën tjetër. Një vijë e rrumbullakët dhe e mbyllur dallojë mbi shkronjat e shtypit. E shikoi atë për një kohë. Iu duk se shumë lehtë do të mund të bënte një portret. Të tërhiqte edhe disa vija të tjera dhe portreti do të ishte gati. Ia kishte ënda të vizatonte. Njëherë, bile, i kishte shkuar mendja se kishte gabuar që nuk i ishte kushtuar vizatimit. Ndoshta do të kishte pasur më shumë sukses sesa në lëndën që po studionte. Vizatimi disi e tërhiqte. Shpesh dhe gati kudo hiqte viza, më parë rrethore, mandej të shkurtra dhe disa pika. Këto pastaj i emëronte ashtu si i kishte menduar vetë, koka, sytë, vetullat dhe të gjitha organet e tjera që ndodheshin në kokën e njeriut. Por, për çudi, të thuash se asnëherë portrete

të këtilla nuk i pëlqenin. Për këtë edhe kishte he-qur dorë nga studimi në akademi. Kjo iu kujtua edhe tani. Vendosi që kësaj radhe të punonte më me kujdes, me një vëmendje më të mdhe. «Do të punoj ashtu siç veprojnë piktorët». I ishte dukur punë e lehtë ajo e piktorëve, që rrrokin furçën dhe fët e fët, me disa lëvizje dore dhe me kujdes, punimi qe gati. Por, edhe kësaj radhe, kur e kreua, iu duk punë naive. Nuk i përngjante fare kokës së njeriut. U hidhëruan. Pjesën e gazetës në të cilën kishin mbetur vijat, që për këtë nuk do të thoshin asgjë tjetër, pos vija pa kurrfarë kuptimi, e shqeu. Ashtu të bërë duq e mbante në dorë. Shoku i bankës e shikoi dhe nuk foli fare. Nuk i pëlqeu një shikim i tillë. Dhe vetëm tani i ra ndër mend se ndodhej në një rrreth të ri. Të gjithë ishin më të rinj se ky. Disa prej tyre, bie fjala, ai ulur afër drifates, mund të ishte edhe djali i tij. E ky u thoshte kolegë. Po, u thoshte kolegë, sepse bashkë po mundoheshin në bankat e këtij fakulteti të ri, që u hap për herë të parë në këtë qytet. Këtu çdo gjë është e re. E re ndërtesa e fakultetit, të rinj studentët, të rinj janë edhe profesorët. Ky është më i vjetri ndër të gjithë. Më i vjetër edhe se profesori që po shpjegonte.

Nuk dëshironte të mendonte për këto gjëra. I kishte lénë fëmijët në fshat dhe kishte ardhur të studionte. I ishte mbushur mendja se i duhej të përqendrohej në mësim më shumë se të tjerët, por nuk mundej. Duke vepruar kështu, kishte thënë me vete, do të harroj çdo gjë, pos asaj për çka kam ardhur. Më kot provoi një gjë të tillë edhe kësaj radhe. Pa dëshirën e tij, disi papritur e pakujtar, i

erdhi një ide e çuditshme. Ide që nuk do ta lejonte të përqendrohej dhe ta përtyponte mësimin. E kishte njohur dikur këtë profesor. Ndoshta jo si profesor. U mundua t'i kujtonte të gjithë njerëzit që kishte njohur më parë. Së paku vetëm ata që i kishin lënë mbresa në kujtesë. Si është edhe mendja e njeriut, mendoi. Ku mund t'i kujtosh të gjithë njerëzit që i ke njohur brenda dyzet e ca vjetësh? Kushedi me sa njerëz është njohur dhe ka biseduar në mal, kur ka qenë me pushkë në krah, e kush mund t'i numëronte të tjerët nëpër shtëpitë e ndryshme të nxënësve. Dhe gati harroi se kishte qenë edhe mësues fshati. Kishte qenë mësues në ditët e para pas Çlirimtit, atëherë kur ndihej një nevojë e madhe për mësues. E ky, edhe pse ende nuk e kishte kryer shkollën e mesme, sepse për çështje politike i pati rënë në sy pushtetit të 'atëhershëm dhe e patën përjashtuar në vitin e dytë, u detyrua të pranonte detyrën e mësuesit. Më parë, disa herë, kishte pranuar dhe kishte kryer me sukses edhe shumë detyra të tjera, që i kishte ngarkuar shoqëria, ndoshta edhe më të vështira. Pse të mos e pranonte edhe këtë! E dinte mirë se më vonë do t'i duhej të kthehej përsëri në bankat e shkollës, për të vazhduar mësimet, atëherë kur nuk do ta linte keq shkollën e fshatit në të cilën do të punonte.

«Mund ta kem pasur shok shkolle!» — kishte thënë, por nuk kishte mundur t'i besonte as këtij mendimi që i erdhi disi papritmas. Nuk mund t'i besonte, sepse mbrëmë e kishte shikuar albumin e fotografive që e mbante me vete dhe nuk i kujtohej ta kishte parë diku fytyrën e atij. I erdhi keq që nuk i kishte sjellë me vete edhe fotografitë e

nxënësve. T'i kujtonte herë pas here ato fytyra të qeshura të vocërrakëve këmbëzbathur që e donin aq shumë. Kushedi sa herë kishin thënë se mësuesi i tyre ishte njeriu më i mirë në botë. E ky tani nuk mund të njohë asnjërin. Si do t'i njihte, kur ata tani janë rritur, kanë ndryshuar edhe fizionomi. Kanë ndryshuar çdo gjë. Të gjitha duken ndryshe. Ndryshe duket edhe fshati. Ndryshe duket gëzimi e ndryshe vaji në buzët e tyre. Nuk është më ai vaji që shpesh, kur largohej prej tyre, e shtynte të qante edhe mësuesin. Nuk e dinte as vetë pse qante. Ndoshta, pse atyre u kishte falur çdo gjë, ndoshta...

Ashtu kokulur bënte mbi bankë disa vija me laps dhe i fshinte përsëri. Dikur e ngriti kokën. Dhe padashur shikimi i ndeshi në atë të profesorit. Ai e vërente më shumë se të gjithë të tjerët. Kur e shikoi ky, profesori uli kokën dhe vazhdoi të shpjegonte. Iu duk shikim i keq, nuk i pëlqeu fare. As vetë nuk e dinte pse nuk i pëlqeu ky shikim. Dinte vetëm një gjë: tani ndodhej para një enigme që e mundonte. Zgjidhja e saj do t'i merrte kohë. Pa e zbuluar atë, nuk do të mund të qetësohej. Vendosi ta zbulonte. Do t'i parafytyronte të gjithë njerëzit që kishte njohur. Në mos të gjithë, vetëm ata që kishin lënë gjurmë në kujtesën e tij. E ky i ruante këto gjurmë, i ruante në shpirt. Ishte vështirë t'i shlyente. As nuk ishte përpjekur ndonjëherë t'i shlyente ato. Në mes të atyre vrragave që kishin lënë njerëzit me kujtimet e tyre, ishin edhe ato të këtij djaloshi, që për këtë tanimë nuk ishte profesor. Këtu ishte nyja që lidhte fijet e një lëmshi të madh, shumë të madh për këtë. Cilat ishin gjurmët që kishte lënë ky njeri në kujtesën e tij? Sikur të mundej, do t'i ndante

të gjitha pjesët e trurit për të gjetur vrragët e vu-losura, kujtimet e hidhura dhe të gëzueshme. Në kë-të mënyrë, ndoshta do të mund t'i dallonte edhe ato të këtij djaloshi dhe kështu do t'i kujtohej çdo gjë. Por kjo ishte e pamundur. Megjithatë, kishte ngulur këmbë ta zgjidhte nyjen për t'i zhvjellë mandej fijet e lëmshit. Për një kohë mbajti vesh, ndoshta mos i kujtohej zëri; ia studioi edhe lëvizjet. Iu duk se çdo gjë ishte e kotë.

Përsëri ia nguli sytë profesorit. Ai, pasi e shikoi disi përmallshëm, u kthyte në anën tjetër, e këtij i mbeti shikimi në dërrasë të zezë. U habit se si profesori kishte shënuar aty shumë gjëra e ky nuk i kishte parë fare. Edhe shkrimi i dukej i njojur. E kishte parë diku. Në shkollë, kur kishte qenë mësues, apo atëherë kur kishte qenë edhe vetë nxënës. E ky kishte qenë dy herë, me ndërprerje, nxënës i shkollës së mesme. Ndoshta ndonjë nga ata që shkruante ato letrat e shumta që i pati endur gjatë luftës. Çdo gjë i ishte ngatërruar. Pjesën e gazetës, të cilën kushedi sa herë e kishte bërë duq dhe e kishte shtrirë përsëri, e hapi pa kurrfarë qëllimi. Shikonte portretin, ato vijat që i kishte tërhequr më parë.

— Sa bukur po vizatoka profesori, — e trembi zëri i shokut të bankës. I shikoi mirë ato vija me të cilat profesori konkretizonte mësimin. Edhe vizatimi i dukej i njojur. Shikoi portretin që kishte bërë vetë, mandej përsëri vizatimin, ato vijat që i kishte tërhequr profesori në dërrasë të zezë. I krahasoi. Kishin diçka të përbashkët, diçka të ngjashme. Ndoshta vetëm vijat e lakuara të këtyre dy vizatimeve përngjanin midis tyre. Nuk ishte i sigurt. I krahasoi duke i shikuar herë njërin herë tjetrin dhe

pas pak u bind se kishte të drejtë të mendonte për njëfarë ngjashmërie në mes të këtyre dy vizatimeve.

Kjo ngjashmëri, që mund të vërehej me vështirësi, e ktheu disa vite përpara. Kujtimet e çuan në një rrugicë të fshatit. Aty afër shkollës, një rrugicë e vogël, në të dyja anët e së cilës lëshoheshin fijet e manaferrave, nisej nga mesi i fshatit dhe të shpinte në mes të pyllit. Gjithmonë i kishte pëlqyer shëtitja në natyrë. Veçanërisht atëherë kur tërë pas-diten e kalonte në dhomë duke lexuar. Atëherë kur për herë të parë kishte nisur detyrën e re, për të cilën as që kishte menduar se do të ishte e këtillë, kaq e vështirë, në një mes të ri me të cilin nuk kishte mundur akoma të mishërohej. Që nga ditët e para jeta këtu i dukej disi monotone, disi e padurueshme. Vërtet më parë e kishte urryer vetminë, e ja ajo tanë po e shoqëronte në këtë fshat. Doli të shëtiste, të shkonte gjer në qendër të fshatit. Atje do të gjente dikë. Do të bisedonte me njerëz, do të shkëmbente mendime. Në qendër të fshatit, aty ku rrinin vazhdimisht të rinjtë, do të gjendej ndonjëri me të cilin të bisedonte një kohë, ta thyente këtë monotonji. Ekte i humbur në mendime, pa vërejtur andej-këndeji. Ndërroi disa hapa, kur një shushurimë që derdhej nga manaferrat ia trazoi mendimet. U ndal dhe u kthyen mbërrapë. Një vogëlush ishte struktur në mes të ferrave. Sa u gëzua kur e pa, aq edhe i erdhë keq që e shihte ashtu. Copa teshash të vjetra i kishin mbetur në ferra. Vogëlushi strukej dhe qante me një zë të shterrur. U nis në drejtim të tij. Vogëlushi, kur e hetoi, mori vrapi. Një fije ferre iu ngatërrua në këmbë dhe ai u rrëzua. E rrroku për krahu dhe e ngriti. U përpoq të bisedonte me

të. Në fillim iu duk memec. Vogëlushi nuk i përgjigjej asnjë pyetjeje të tij. U mundua të gjente mënyrat më të mira t'i afrohej, të tregohej i afërt me të. Vogëlushi vetëm dridhej. Dyshoi se ai mund të kishte diçka që e frigonte atë. Shikoi veten, por nuk pa asgjë që mund ta kishte friguar vogëlushin. Atëherë iu kujtua ajo biseda që kishte pasur me atë fshatarin, i cili i kishte treguar se si shumë gra në fshat i frigonin fëmijët duke u përmendur mësuesin. E troi çastin kur kishte vendosur të pranonte të bëhej mësues. Atëherë kishte menduar se askush nuk do të frigohej prej tij, e aq më pak fëmijët, që do ta donin. Bisedonte (në të vërtetë ky fliste e ai heshtte) me vogëlushin dhe ia lëmonte flokët, e përkëdhelte duke i prekur me dorë gjunjët, që i kishte vrarë kur ishte rrëzuar. Pas pak vogëlushi i buzëqeshi. U gëzua. Më vonë ai i tregoi se ishte friguar nga ky. Ishte friguar, sepse i ishte dukur si ata që i kishin marrë një natë babanë, i cili nuk ishte kthyer më nga shtëpia. Jetonte tani vetëm me nënën plakë.

Të nesërmen, në bankën e parë të klasës së parë rrinte ulur ai vogëlushi i ferrave. Herëherë mësuesi i buzëqeshë, por dhe ai këtij. Në fund të vitit ishte ndër nxënësit më të mirë. Vitin e pestë djaloshi i vijoi mësimet në një shkollë në qytet. Po atë vit u largua edhe mësuesi nga fshati. Vardin e tij e zuri një mësues vendas. Edhe pse përmallimi i fshatarëve e preku kur u ndanë, e ndiente veten disi të lumtur. Nuk e dinte pse: se erdhi tjetri ta zëvendëson, apo se do të vijonte mësimet më tej, pas largimit nga ky fshat.

Të gjitha këto iu kujtuan tani. Këtu në të vërtetë merrte fund pjesa e parë e një romani të pashkruar, pjesa e dytë e të cilat do të duhej të fillonte ndryshe, me një përbajtje tjetër e me protagonistë të njëjtë. Sa u përmallua kur e kujtoi gjithë këtë, aq u gëzua se e gjeti fijen e lidhur të lëmshit, zhvjellja e të cilat do ta lironë nga një barrë, e cila i ishte ngarkuar prej çastit kur e kishte parë profesorin e ri që përherë të parë dilte para studentëve të këtij fakulteti. E ngrit kokën. Ca pika lotësh i ranë nga mjekra në dysheme. E shikoi edhe një herë djaloshin që i rrinte përballë, pranë dërrasës së zezë dhe shpjegonte, por nuk e dalloi mirë nga lotët. E futi fletoren e shënimave në xhep dhe pa folur fare, me hapa të lehtë, i përcjellë nga shikimet e studentëve dhe të profesorit, doli nga dera.

Profesori tani nuk e ndiente veten të qetë. Fytyra herë i skuqej, herë i zverdhej. Zëri i bëhej përherë e më i ulët. Thuase i mbeteshin fjalët në fyt. U mbështet në katedër dhe qëndroi ashtu një kohë. Ora e mësimit ende nuk kishte mbaruar. E la shkumësin në një kënd të dërrasës së zezë dhe doli jashtë duke përplasur derën.

Studentët shikuan njëri-tjetrin dhe nuk folën fare. Askush nuk dinte çka kishte ndodhur.

## N D R Y S H I M I

Flokët e borës thyheshin në xhamin e dritarës. Një grup nxënësish thuase donin ta përbimin stufën me qymyr kaluar në mes të dhomës, ku studionin pas dreke. Të tjerët ishin mbledhur në një kënd rreth Zenunit, që luante shah me Ymerin, një djalosh shkurtalec, me fytyrë të rru-mbullakët dhe të plotë. Këta ishin shokë banke dhe rivalë shahu. Luanin gdo ditë në kohën e lirë, dhe ishte vështirë ta dije se cili luante më mirë, se cili kishte fituar më shumë. Zaten, as ata vetë nuk i numëronin fitoret. Luanin, duket, vetëm sa për të kaluar kohën, siç thuhet, në këto ditë dimri.

Zenuni e kishte mbështetur kokën në mes të duarve dhe bërrylat i kishte vënë mbi bankë. Në shikimin e parë dukej se po e analizonte me kujdes lëvizjen që do të bënte. Por, kur luante, të krijohej bindja se ky sot për herë të parë po luante shah e po mësonte se si lëviznin figurat. Ai as që e kishte mendjen te shahu, edhe pse ishte ulur përballë kundërshtarit.

«Shahu! Një dërrasë me katrорë të ngjyrosur e mbi të figura të llojullojshme. Të gjitha të punuara mjeshtërisht prej druri, drurit të ahut që rritet në malet tonë. Sa ndryshime kanë pësuar të gjitha këto, dërrasat dhe figurat, gjersa kanë marrë formën që kanë tanë! Hëm!»

I shikoi edhe një herë të gjitha figurat. Në vend të ushtarit të zi ishte një copë shkumës. Iu kujtua se të djeshmen i kishte rënë në stu-fen e ndezur dhe flaka menjëherë e kishte kapur ushtarin e zi të shahut të tij, që e kishte blerë para disa ditësh. Ishte përpjekur ta shpëtonte, por më kot. Flaka kishte qenë e madhe.

«E rröku flaka. Nesër, nga moskujdesi im apo i dikujt tjetër mund të humb edhe ndonjë... E zëvendësojmë me shkumës ose bëjmë një tjetër. Prej drurit më...» Dhe u ndal një kohë. «Si figurat e shahut mund të humbin edhe njerëzit! — iu duk se e bëri një krahasim të qëlluar. — Por njerëzit si mund të zëvendësohen?!» — e shikoi edhe një herë shkumësin. Në mesin e figurave të shahut iu duk një zbrazëtirë. Shkumësi nuk e kishte zëvendësuar ushtarin e humbur. Edhe pse kishte zënë vendin e tij, ai kishte krijuar një larmëri, që e prishte edhe bukurinë që krijonin të gjitha figurat e vendosura në vendet e veta. Diçka megjithatë mungonte aty. E kjo i kujtoi diçka tjetër, diçka që përpiquej ta harronte një herë e përgjithmonë.

«Babai im i dashur! Edhe ai humbi diku në mal!». Para sysh, si nëpër mjegull, i dolën dy duar të mëdha, të plasaritura dhe të lyera me rrëshirë që kishte vënë kore. Ishte disa vjet më i ri atëherë

kur me plot bindje kishte pohuar: «Nuk ka më të fortë se këto duar. Nuk prish punë se janë të plasaritura; kanë ndërruar ato sa e sa sharra e sëpata, të cilave tani nuk u dihet as fija. Dhe ja ai gishti tregues, plot e përplot të çara, kushëdi sa herë është rrudhur në çarkun e pushkës. Është rrudhur atëherë kur i është cënuar nderi dhe sulmuar vendi. Është rrudhur pa kurrëfarë frike.»

Për këto të fundit i kishin folur të tjerët, sepse i ati, sa herë e kishte pyetur ky për të kaluarën, ose kishte heshtur ose kishte filluar një bisedë tjetër. Por ja, edhe atë e përbiu mali. E përbiu mali në të cilin ishte rritur, në të cilin kishte përjetuar gjëzimin dhe hidhërimin e parë, kishte dëgjuar së pari dhe së fundi këngën e bilit, që nuk di të pushojë gjersa kurora e bardhë mos mbulojë çdo gjë. Sa i bukur dhe sa i pamëshirshëm është ky mali ynë, nga i cili ndoshta edhe është marrë druri për shahun me të cilin po luajmë! Kushedi...

Shoku i babait, Shabani, vetëm pas disa vjetësh, kur i ishte mbushur mendja se ky tani është i rritur, i kishte treguar hollësishët se si kishte ngjarë e gjithçka rrëth vdekjes së të atit. Ky e kishte dëgjuar me vëmendje, por nuk kishte mundur ta mbante në mend krejt çka i kishte folur Shabani. I kujtoheshin ato më kryesoret.

— Njeriu kishte mbetur pa dru në mes të dimrit. Nevoja ku nuk të shtyn. Ta humb edhe kryet, mos harro, djalë i mirë, ti je i ri e nuk i di këto. Nevoja të shtyn, e puna të mashtron. — Dhe Shabani kishte nxjerrë kutinë, kishte mbështjellë cigaren dhe, pasi e kishte ndezur, kishte vazh-

duar: — Gati i patëm mbaruar ato të ngrëna dreqi. Po shkurtonim një lis të madh, që e patëm rrëzuuar para dreke. Ishte trupi i tretë, më kujtohet si sot. Babai yt, rahmet pastë, gjithmonë i rrinte sharrës në anën e poshtme. I thashë disa herë të ruhej. Lisit i vunë disa gurë e cungje që të mos rrrokotelej. Por vdekjes nuk mund t'i shpëtosh! Ti ndoshta nuk beson, por e ke keq. Nejse, si isha duke të treguar, e shtrënguam lisin që të mos rrëshqiste. Por a sigurohet bora e malit? — Shabani kishte thithur thellë cigaren dhe e kishte shkuar drejt në sy. Ky nuk kishte ditur çka të thoshte. Ai kishte vazhduar: — Ajo ishte zbutur e neve nuk na kishte shkuar mendja se mund të rrëshqiste. Ishte grumbulluar dalngadalë nga bregu dhe na kishte vënë përpara bashkë me lisin. Çka ka ndodhur më tutje nuk e di. Më kujtohet se, kur kam çelur sytë, isha i shtrirë në shtrat dhe ndieja dhembje. Dhoma ishte mbushur me miq e të njobur. «Ku jam?» — pyeta pasi e piva gotën e ujit. «Në shtrat!» — më tha dikush. Nuk ia dallova zërin. «Kapërceva!» Më vonë më treguan se pas tri orësh na kishin gjetur nën borë — mua të gjallë e Sinanin të vdekur. Një gjahtar e kishte parë ortekun dhe kishte lajmëruar në fshat. Ishin tubuar të gjithë, kush me lopatë e kush me kazmë. E kishin larguar borën.

Shabani i kishte rrëfyer edhe më hollësisht. Kështu e kishte përmbledhur ky rrëfimin për të atin, që ua kishte treguar disa herë shokëve. Në fillim i dukej se, sa herë e tregonë atë, e ndiente veten më mirë. Më vonë kishte ngjarë e kundërtta. Kur e tregonë ditën, natën e shihte në ëndërr.

Trembej natën, bërtiste sa i zgjonte të gjithë, prançaj përpiquej që të mos e kujtonte asnjëherë.

«Sa të mirë janë fshatarët në kësot rastesh! Nuk kursejnë asgjë. Merre me mend, sikur të mos kishin shkuar të gjithë, do të vdiste edhe Shabani.»

— Shah, sheh, Gash (kështu e thërritnin të gjithë shokët Zenunin), — e trembi zëri i Ymerit, i cili e lëvizi kalin prej fushës së zezë në të bardhën dhe mori ushtarin. — Mbretëresha shkoi! — dhe i fërkoi duart prej gëzimit.


Zenuni shikoi njëherë figurën e shahut, mandej Ymerin dhe qeshi disi me zor. Pamja e fytyrës i kishte ndryshuar. Nuk ishte më ai djaloshi i gëzuar, i gatshëm që edhe në situata të këtilla t'i dëfrente shokët me ndonjë mahi<sup>1</sup>).

«Mbretëresha shkoi. Pse ta luante mbretin! Deri kur ky privilegji? — i erdhën si papritur këto mendime. — Hëm!» — bëri kur iu kujtua se mbreti për të ekzistonte vetëm në shah dhe se duhej ta respektonte që të mund të fitonte.

E lëvizi mbretin në fushën e bardhë. Kur Ymeri mori mbretëreshën, iu kujtua se diku kishte lexuar se si jeta e njerëzve u ngjan figurave të shahut të shtruara në një dërrasë, fati i të cilave varet nga dora që i lëviz. Së pari i ishte dukur mendim i qëlluar. Tani ishte bindur se nuk përkonte me të vërtetën.

«Dikush të luajë me fatin tim! Kush është ai? — Autori i mendimit që iu kujtua, ndoshta kishte menduar zotin. — Ku është zoti? E di se nuk ekziston». Lëvizi kokën në shenje dyshimi.

1) shaka



«Megjithatë dikush luan me fatin tonë. Kush  
është ai që vendos për fatin tim? Unë vetë. Por,  
pse nuk vendos atëherë vetëm mirë?» — e kishte  
pyetur diçka nga brenda dhe i ishte përgjigjur aty  
për aty. «Nuk lejojnë kushtet. E ato kush i ndry-  
shon? Vetë njerëzit. Edhe unë. Kam filluar t'i  
ndryshoj qysh tan!» — E kishte mundur vet-  
veten. Të gjitha dilemat tani kishin marrë fund.  
Përsëri i ishte kujtuar i ati. Jeta e tij. Ishte për-  
pjekur të bënte krahasime në mes atij dhe ve-  
tes...

— Mat, Gash! — u dëgjua përsëri zëri i tra-  
shë dhe kumbues i Ymerit.

Nxënësit përreth e komentonin:

- Ka luajtur shumë dobët.
- Nuk është përqëndruar mirë.

— Sigurisht ka marrë ndonjë njësh sot.

Zenuni e shikoi këtë që foli i fundit. E mati  
nga koka gjer te këmbët. Uli kokën që të tjerët  
të mos i hetonin sytë e përlotur.

Kur i rregulluan figurat për partinë e dytë,  
edukatori hyri në dhomë dhe është shenjë se ishte  
koha të fillonte studimi i rregullt i pasdites. Ata i  
paluan ato në kuti dhe, pasi zunë vendet e veta  
nëpër banka, hapën librat.

Jashtë flokët e borës, thuase vinin nga pylli  
i Gërlisë, binin pa ndërprerje. Era i përplaste në  
xhamin e drirates. Kur ndesheshin në të, shkrihe-  
shin dhe rrëshqitnin tatëpjetë. Rrallë ndonjë futej  
brenda nëpër këndin e thyer të xhamit të dri-  
tates, pranë së cilës rrinte Zenuni. Zgjati dorën  
dhe rrroku një. E shtrydhi. Floku u shkri. Dora i  
mbeti thatë, por e lagur.

SHENJÈ NÈ LIS

E shtrui plafin nën hijen e lisit të vjetër, maja e të cilët dukej se po e shponte kupën e qillit të pastër. U ul dhe filloi të lexonte librin që i dha shoku më i ngushtë ditën kur u nis për në fshat. Para dy ditësh ishte kthyer në vendlindje. Këtu do të kalonte pushimin vjetor. I ishte mërzitur bregdeti, madje edhe pushimoret në të cilat vijnë njerëzit nga meset e ndryshme. Më në fund, çfarë bukurie më të madhe kishin ato në krahasim me këtë ambient. Bile, këtij i dukej se këtu është më bukur se ikudo tjetër. E donte këtë vend, e donte edhe këtë lis. As vetë nuk dinte ta shpjegonte se çka në të vërtetë e lidhte me këtë vend. Ndoshta e donte se ai i kishte njohur vajin dhe gjëzimin e parë, në pyjet e tij kishte lënë lekkat e pantollave të vjetruara, duke vrapuar pas lopëve kur i rrakte të nxehjtët, në ditët e fëmijnisë. E tani i dukej se disi ishte larguar nga ky ambient, nga këta njerëz, sepse, edhe pse fshati ishte i vogël, ai nuk i njihte të gjithë, nuk i njihte djelmoshat që rritheshin si fieri. Për ndonjërin pyeste si e kishte emrin, e për tjetrin i kujt ishte.

Kur i tregonin, lëvizte kokën dhe fytyra i skuqej.

Lisin, nën hijen e të cilit ishte, e donte edhe pér diçka tjetër. Ai e ndihmonte që, prej së largu, ta dallonte vendin ku strukej shtëpia e tij e lindjes. Ngrihej lisi si ndonjë përmendore në një kodër të fshatit dhe vetëm disa metra më larg strukej një kasolle e vogël, oxhaku i së cilës tymoste në qdo kohë. Sa e kishte dashur dikur këtë kasolle! E donte edhe tani. Në oborrin brenda mureve të saj e ndiente veten shumë të lirë, madje më të lirë se në banesën e vet në qytet. Dimrit thuase ajo vetvetiu e ngrohte, e verës e freskonte. Këtë ia kishte thënë disa herë kushëritit të vet. Ai vetëm e kishte shikuar, sikur të thoshte se pse atëherë e ka lënë. Ky ishte quditur se si nuk e kuptonte. Pérndryshe, me çka do të jetonte këtu. Pér fshatarin toka është gjithçka. E këta kishin aq pak, sa vetëm pér njërin vëlla mjaftonte. Tjetri do të duhej të kërkonte çare tjetërkund...

Era e lehtë që lëkundte degët e bungut mijevjeçar thuase e ndihmonte të shfletonte fletët e librit, ngjarjet e të cilit e tërhiqnin. Ishte ky një libër me tematikë bashkëkohore. Disa nga peripeticë e protagonistit në një mënyrë i kishte përjetuar edhe vetë. Kur e kreua kapitullin e tretë, këputi një fije të gjatë bari dhe e vuri në mes të faqeve që po lexonte. E mbylli librin. Me gishtat e dorës së djathtë ferkoi sytë. Shikimi mandej iu tret në fundin e fushës së gjerë që shtrihet para tij. E mati atë prej këndit më të largët, prej atje ku i dukej se qelli kishte zbritur në majat e bjeshkëve e gjer te rrënjet e lisit. E shikoi edhe

lisin. U mundua t'ia shihte edhe majën e fshehur nga degët dhe gjelbërimi. Duke e shikuar ashtu, i tërroqi vëmendjen diç që nuk i kishte rënë në sy më parë, apo që e kishte harruar. Degët e listit dilnin nga dy ose tri nga i njëjtë vend dhe shpërndaheshin në drejtime të ndryshme për të formuar kështu disa rrathë në mesin e të cilëve mbeteshin edhe zbrazësira. E shikoi atë për një kohë të gjatë, nga lart poshtë. Sa më lart, aq më të dendura ishin degët. Në fund, në një pjesë bukur të madhe të listit nuk kishte asnje degë. U ngirit që ta maste atë pjesë të pastër. Në pjesën e lëmuar të trungut dalloi disa via. Në fillim nuk i dalloi çka ishin. Me vështirësi dallohenët gjermat e shtypit, të gdhendura me brisk kushedi para sa vitesh, që mezi lexoheshin *Hasan Shpati*.  
Gjatë pëshpëriti E njoj këtë njeri.

«Hasan Shpati», pëshpëriti. E njoh këtë njeri. Në të vërtetë e kam njohur. Ishte babai i Selmanit. Ai plaku që mbante veshur... thuase donte ta bindte veten se me të vërtetë e kishte njohur. Plakun që kishte vdekur. Nuk i kujtohej se çka mbante veshur. U mundua ta kujtonte me diçka tjetër: në fizionomi, me gjatësinë e trupit, me qeshjet, me pamjen e fytyrës, në... Të gjitha ishin të kota. U shtri në plaf. Shikimin e drejtoi nga qielli. Në të vërtetë as që shikonte kund.

Atëherë ishte nxënës i shkollës së mesme. Ditëve të vjeshtës prindët më rrallë i shkruanin letra. Në këtë stinë ata mbledhin frytin e punës së tyre e kush ka kohë të mendojë për letra. Për këtë arsyen edhe ishte habitur kur i tha kujdestari se kishte një letër nga fshati. I shkruante i vëllai. Disa herë e kishte lexuar atë letër, më shumë nga

pikëllimi apo se i kishte pëlqyer shprehja konçize e plot përmbajtje: «Këto ditë një herë e përgjithmonë u largua nga mesi ynë plaku më i dashur i fshatit, Hasan Shpati. Vdekja e papritur e rrëmbeu, edhe pse ishte i sëmurë vetëm dy ditë.» Vëllai i kishte shkruar mandej gjerësisht pér plakun. I kishte shkruar pér ato që ky i dinte. Sepse, edhe vetë, si të gjithë djelmoshat e fshatit, e donin plakun që ishte më i afërt me ta.

E tani nuk i kujtohej fizionomia e tij. U ngrit dhe filloi të ecte. «Sa kujtesë të dobët që kam», mendoi dhe u frigua nga ky mendim. «Kam mbajtur mend sa e sa fytyra që i kam njojur nga librat dhe kam harruar atë që e kam njojur vetë. I përngjante, i përngjante.»... — e vuri gishtin në kokë pér të kujtar protagonistin e ndonjë libri të lexuar, të cilil do të duhej t'i përngjante Hasan Shpati. Edhe kjo përpjekje qe e kotë.

Nga xhepi nxori briskun e vogël dhe me majaën e tij filloi të gdhendte shkronja në lëvozhgën e trashë të lisit. Pranë shkronjave të gdhendura dikur, që tani dukeshin edhe më të mëdha, mbetën ato të shkruarat tami. Dy emra pranë njëri-tjetrit. Dy emra njerëzish të **një fshati**, por të **dy gjeneratave**. Hasan Shpati nuk ishte më i gjallë. Bedriut iu duk se emri i tij nuk ishte më i gjallë. Bedriut iu duk se emri i tij nuk do të duhej të shënohej pranë atij të plakut. As vetë nuk e dinte pse kishte vepruar në këtë mënyrë.

Një re e shkapërderdhur notonte në qiellin e kthjellët në drejtim të Gjeravicës. Prej andej vinte një fresk i lehtë që përshkonte fytyrën e

gjerë dhe gjithmonë të qeshur të Bedriut, që tani kishte marrë një pamje të rëndë dhe të mbyllët. Reja notoi nëpër hapësirë e u zhduk pas bregores dhe qelli mbeti përsëri i pastër. Bedriu mundohej t'i hetonte gjurmët që kishte lënë ajo në hapësirën e qillit nga kishte kaluar. Dielli me flakën përcëlluese kishte zhdukur çdo gjë. Ky nuk kishte guxim ta shikonte diellin. I mbylli sytë. Nuk kotej, por megjithatë iu duk se kishte parë një ëndërr. Ishte ëndërr apo e vërtetë, diç që kishte ndodhur dikur e që tani i kujtohej.

Tymi i përzier me flakë dilte nga tjegullat e një shtëpie të vjetër, e cila ngjante me furrën e ndezur të gëlqeres. Përreth ishin tubuar njërexit. Të gjithë burrat e fshatit qëndronin dhe shikonin pa ditur çka të bënin. Ishin shtangur. Zjarri sa vinte e rritej. Dikush kishte hapur lajmin se gjithçka me vlerë me kohë ishte nxjerrë nga shtëpia.

— Halili, Halili, djali im! Në zjarr... po kalllet...! — Gruaja e shkurtër trakte pér krahun sa njërin sa tjetrin dhe i përsëiste të njëjtat fjalë. Vonë iu kujtua të shtonte: — Para se të shihej flaka, ai po luante brenda me fëmijët. Tani nuk është askund...

Turma u përzeie. Njerëzit u tubuan rrëth gruas. Vetëm njëri kishte hetuar dikë me gëzof që ishte përzier njëherë me flakën dhe mandej ishte zhdukur. Ai nuk kishte arritur të thërriste se po digjej njériu, kur burri i gjatë, i veshur me tirq të bardhë lesqi e lëshoi fëmijën e tërmekur në duart e së ëmës dhe vetë u hodh në vijën e ujit. Gëzofi i leshtë digjej mbi ujin që e mbante. Burri

ktthehej herë në njërin herë në tjetrin krah. Kur u ngrit, i dallosheshin disa pulla në ftyrë. Më vonë ato iu shndërruan në plagë, që pas shërimit i mbetën shenja.

Tani çdo gjë i ishte e qartë. Kjo nuk ishte ëndërr. Ishte ngjarje e vërtetë. Kishte ngjarë para disa vitesh. Bedriu për këtë u kishte folur disa herë shokëve të klasës. Bile, mburrej me solidaritetin e fshatarëve të vet.

I shikoi edhe një herë shenjat në lis. Me majën e briskut vazhdoi të gdhendte mbi ato që kishte shënuar më parë. Një pjesë e bardhë, fare e bardhë mbeti afër shkronjave të mëdha e të qaraveshura që mezi lexoheshin. U gëzua. U gëzua që kishte vepruar në këtë mënyrë. «Emri im pranë të tijit nuk e ka vendim! Nuk jam unë si ai», — dhe e ndjeu veten të çliruar që kishte fshirë emrin e vet.

«Pse e prishe? — i kishte thënë diçka nga brenda. — Ai të ka dashur. Kur ktheheshe në fshat, të kujtohet, të ndalonte në rrugë, të përqafonte duke ta gërvishtur ftyyrën me mustaqet e imprehta».

«Emri i tij nuk besoj të jetë shënuar diku tjetër, pos më librin e të vdekurve edhe këtu. Kush e ka shënuar këtu? Nuk ka rëndësi. Le të mbetet edhe këtu i vetmuar. Do t'u kujtojë njerëzve plakun dhe veprën e tij.»

Dielli i ishte afruar kodrës së fshatit. Bëdriu e mbylli librin. E kishte paluar edhe plafin dhe ishte nisur për në shtëpi. Asnjë ditë tjetër nuk kishte lexuar më pak se sot. Nuk ishte dëshpëruar, përkundrazi. Ishte gëzuar...

## ENDRA

Pranë stufës së ndezur në mes të dhomës, dritat e së cilës shikonin nga malet me borë, rrinin Ramushi e Tahiri. Ky i fundit, një djalosh fytyrëhajshëm, me mashën që e ka lëshuar ndërmjet gjunjëve të rrudhur bën vija në dheun e dhomës dhe herë pas here i shikonte ato si të mendonte se çfarë vije tjetër duhej tërhequr tanë pér t'i dhënë formën përfundimtare ndonjë skice. Kurse Ramushi e ka mbështetur kokën në jastek dhe ashtu i shtrirë të duket se, nëpër mjegullën e tymit të cigareve të mbështjella pa kujdes e shije me një copë gazetë, shikon letrën në këndin e dritäres, që, sa herë hapet e mbyllët dera e dhomës, fryhet e shfryhet duke lëshuar njëfarë tingulli të mërzitshëm. Këtu i kishte mbetur shikimi këtij që nga casti kur u bind se ai sendi i zi në mes të borës, në kodrën përbri nuk ishte njeri që po vinte në drejtim të shtëpisë së tyre, siç iu duk në fillim, por kaçubë prej së cilës kishte rënë bora.

— Fol diçka, mixhë. Sot vetëm po thith cigare pas cigareje.

Zëri i nipit, që e theu heshtjen, e cila kishte mbretëuar një kohë të gjatë në dhomë, e kujtoi Ramushin se këtu nuk ishte vetëm. Disi u gëzua, thuase nuk e kishte ditur edhe më parë se kishte me kë t'i ndërronte mendimet, t'i tregonte dikujt së paku vetëm diçka nga gjithë ajo që tani e mundonte. Ramushi ishte i vetëdijshëm se edhe në këtë bisedë të tërthortë për një fshehtësi për të cilën dinte vetëm ky, e fshehta duhej të mbetej përsëri e fshehtë.

— Sigurisht ke dëgjuar se çka thonë plakat kur njeriu sheh ndonjë èndërr të tmerrshme, diçka që të hidhëron për së tepërm? — e pyeti ky Tahirin.

— Pa e ditur èndrrën, nuk di çka të them, — foli Tahiri. Ai në të vërtetë kishte dëgjuar shumë fjalë nga plakat për èndrrat, por vetë nuk dinte të shpjegonte asnijë. Axbës i tha vetëm që ta vazhdonte bisedën.

— Ta zëmë, sheh èndërr që t'i ka shtënë dikush thonjtë në fyt, ose se ia ke shtënë ti dikujt dhe tani e shikon se si i zbardhen sytë, sikur duan t'i dalin jashtë. — Tahiri ngriti kokën dhe shikoi këndin e dhomës.

— Këso èndrrash nuk më ka rënë të dëgjoj asnjëherë! — tha ai pas pak. — Vetëm më kujtohet njëherë kur halla Shake i pati thënë babait: të shohësh èndërr se po të mbyt kush është mirë për ty, e të shohësh se ti po e mbyt dikë... Por, më në fund, çka mund të thonë për çdo èndërr që sheh njeriu netve të dimrit?

Axbë e nip vazhduan bisedën për èndrrat e dimrit, të cilave nuk u duhej besuar aq shumë.

Tahiri përpinqej të shpjegonte edhe shkakun dhe arsyen pse sheh njeriu ëndrra. Ato herë-herë lidhen me ngjarjet reale, sipas tij, e herë-herë tuk kanë asgjë të përbashkët me këtë. Kur u lëshua muzgu i mbrëmjes, djaloshi u çua, sepse duhej përgatitur darka për bagëtinë.

Në dhomë vendin e dritës po e zinte gjithnjë e më shumë terri. Drita, që dilte prej zjarrrit nëpër vrimën e derës së stufës dhe derdhej në derën e dhomës, bëhej gjithnjë e më tepër mbizotëruese. Ramushi i ishte afruar derës së stufës. E mbushi me dru. Kur futi cungun e fundit, cungjet e tjera lëvizën dhe nëpër dheun e dhomës u shpërndanë gacat. Njëra prej tyre shkoi gati te dera. Ai u zgjat ta merrte dhe disi padashas sytë i shkuar në murin ku lëvizte hija e tij. Kjo hije iu duk si njeri, prandaj as nuk u kthyte ta shikonte. I fryu pak stufës dhe, kur u kthyte prapa, nga muri doli një njeri. Ishte shumë i afërt me të. Njeri që fliste me plot mend.

«Për të gjitha ka qenë dashur të mendoheshë me kohë, atë natë, para se t'i përgjakje duart!»  
the njeriu që doli nga muri.

«Nuk kam pasur kohë të mendoja. Çdo gje  
është zhvilluar me shpjëtësi rrufeje.»

«Nuk është zhvilluar vetë, por ti ishe motori i saj. Ishe nxehur në krye dhe thuase po këpuptje ndonjë lozë kungulli.»

«Ke të drejtë. Por a e di se në çfarë si-  
tuate kam qenë? Sa u mbështeta te dërrasat e  
mullirit, më mashtroi gjumi. Zhurma më zgjoi.  
I hapa sytë: njeriu kishte hedhur thesin në shpi-

në. U frigova. E di edhe vetë se si është njeriu kur zgjohet nga gjumi.»

«Sikur të kishte menduar të të vriste, më parë do të kishte kryer punë me ty, sesa ta hidhte thesin në shpinë.»

«As unë nuk kam menduar se do të më vriste.»

«Ha, ha, ha. Atëherë pse i re në tepe të kresë qykë sëpate me tërë forcën?»

«Të lutem, mos më mundo, kur edhe vetë e di se si ka ngjarë. Që nga ajo natë dora e djathët më duket si e huaj. Njëherë më shkoi mendja ta këput. Sepse me të vërtetë, më beso, nuk kam menduar t'i bie aq fort. Kjo si të lëshohej mbi ndonjë shkëmb prej bregut të rrëpinjtë. Bum, në tepe të kresë, e njeriu i vdekur.»

«Po mirë, atëherë, pse nuk u bëre burrë e të pranoje se ti e ke përcjellë nga kjo botë Sadikun. Të tregoje edhe pse e ke vrarë, po e mbështolle me pondla<sup>1)</sup> të thasëve dhe e le në mëshirën e qenve buzë përrroit pa i hedhur së paku dy grushte dhe sipri?»

«Gjithmonë u jam friguar gishtave të drejtuar kah unë.»

«Jo, por je friguar se edhe ty do të ta bëjnë nesër ashtu. Sepse njerëzit edhe kështu po tregojnë me gisht pas shpinës sate. A nuk i ke vërejtur se si po flasin e po sillen me ty?»

«Askush nuk e di se unë jam vrasësi i Sadikut. Si të dyshonte ndokush, do të thoshin edhe

---

1) zhele, lecka

për mua siç kanë thënë njëherë për Veselin e mandej për Rexhepin.»

«Ti mendon se nuk dyshojnë.»

«Nuk mendoj, por jam i sigurt. As zogjtë e malit nuk më kanë parë. Madje, për të mos dyshuar tek unë, jam hedhur në anën tjetër të përrroit, andej nga mëhallat e Matoshëve.»

Në korridor u dëgjuan hapat e njeriut që po vinte në dhomë. Njeriu i murit u shndërrua përsëri në hije, që lëvizte vetëm kur lëvizte Ramush. Edhe kur u tubuan të gjithë meshkujt e shtëpisë në odë, ai u mbështet përsëri pas murit, në mes të dy dritareve. Për një kohë të gjatë u mundua të zbërtente se sa kishte pasur të drejtë ai njeriu që kishte dalë nga muri, kur i kishte thënë se ishte dashur të mendonte me kohë. Pse mu tanë të më këshillonte kështu. Ku kishte qenë atëherë, në çastin më të nevojshëm, ta ngrinte dorën dhe ta rrokte sëpatën. Sikur të kishte vepruar kështu kur ishte dashur, me siguri nuk do të ngjante kjo që edhe tanë nuk më hiqet nga sytë: njeriu i shtrirë gjerë e gjatë në dysheme të mullirit dhe gjaku gati sa s'ka arritur tek ai thesi me grurë. Bri tij qëndronte tjetri si ndonjë trim legjendar dhe vetëm e shikon këtë çudi. Pas pak kërkon disa pondla, e mbështjell me to dhe e hedh në shpinë.

Kishte ngjarë kjo para më se një viti. Nëpër tubime të burrave shumë pak bëhej fjalë tanë përkëtë. Së paku, më pak sesa në fillim. Këtij i kuqtohet mirë se si pak pas vdekjes së tij në një tubim burrash që folur gjerë e gjatë për kufomën e gjetur buzë përroit, që kishte filluar t'i vinte

era. Burrat e dheut kishin thënë me atë rast se vështirë ishte të gjendej dorasësi, sepse ai kishte qenë mjeshtër i vërtetë pér t'i humbur gjurmët. Kur njëri nga të pranishmit tha se ai kishte dëgjuar të flitej gjoja pér vrasjen e Sadikut në shtrat të gruas së huaj, Ramushi qe skuqur në fytyrë. Doli nga oda. Prej atij çasti kishte filluar të mendonte edhe më shumë pér Sadikun. Të turpërohej njeriu i vdekur pa qenë i përzier në aso punësh, vërtet nuk kishte hije. Hajnia e kurvënia nuk janë larg njëra-tjetrës, por motivet janë të ndryshme. Pér të parën nganjëherë të shtyn edhe nevoja. Mendimet shkonin e vinin njëri pas tjetrit në kokën e tij.

As kur u shtri nuk e zuri gjumi. Rrotullohej sa në njërin sa në tjetrin krah. Ngrihej e ndizte cigaren e mandej përpinqej përsëri t'i mbyllte sytë. Vonë, shumë vonë, e kishte mashtruar gjumi. U zgjua i pikelluar. Një èndërr e tmerrshme e kishte zgjuar. I mbylli prapë sytë dhe ajo që i ishte shfaqur në èndërr iu përsërit. Kur kishte vendosur të shkonte nuk e dinte as vetë. Trokiti në derën e dhomës së Maxhunit. Oda ishte plot e përplot me burra të zgjedhur, të përmendur në këtë anë pér trimëri e mençuri. Në ballë të oxhakut, ulur këmbëkryq, me bërryl të mbështetur në gjurin e djathtë, rrinte mixha Hasan. As këtij nuk i pëlqeu prania e Ramushit në odë. E shikoi një herë dhe uli kokën. Me dorën e lirë i dridhëtë fijet e postajës, mbi të cilën ishte ulur. Ramushi i pëershëndeti burrat. Asnjëri nuk iu. përgjigj. U ul pas derës.

«Mos prite të të qesin në krye të odës!»

— i tha njëri, pasi ky e mbështollti cigaren nga kutia e vet.

«Asnjëherë nuk kam dalë në krye të odës.»

«Por, më parë nuk ke qenë trim. Tani po! — vazhdoi ai. — Në kohërat e vjetra njerëzit që vritnin dilnin në krye të odës, në ballë të oxhakut.»

«Ashtu ishte!» — u përzie ai thataku që rrinte në anën tjetër të oxhakut. Ramushi nuk e dinte se a fliste sinqerisht apo tallej.

«Lërmëni në hallet e mia, burra!» — klithi ai.

«Mirë e ke. E ke vrarë njeriun e tani kërkon mos të të thotë kush gjë. I mençëm je ti!»

«Kur të mbështetin për muri, nuk ke ku shkon më tej. Shtëpia jote është muri i fundit. Mulliri për mua është shtëpi.»

«Sadiku nuk ishte njeri që e ka mbështetë kend për muri.»

«Ka vjedhë, burra, apo ju duket pak kjo?»

Një qeshje cinike e mbushi odën.

«Trimat luftojnë me burra të fortë. Ballë për ballë.»

«Unë nuk jam trim.»

«Ti je frigacak. Vetëm frigacakët vrasin si ti.»

«Ata duan t'ia humbin gjakun njeriut që vrasin. Ta poshtërojnë të vdekur.»

«Por, a di çka, nuk do të bëje keq të shkoje në punën tënde, — ndërhyri mixha Hasan, që deri tani vetëm kishte dëgjuar. — Mos u duk tjetër herë në odë të burrave. Rri me fëmijë e gra. Atje e ke vendin!»

«Vetë do t'i shkoj në derë vëllait të Sadikut. Do t'i tregoj fije për pe!» — tha prerë Ramushi kur hapi sytë.

Dita ishte shumë e gjatë. Në mbrëmje u tha meshkujve se po shkonte te një kushëri në fshat. Nëse vonohej, të mos bëheshin merak. U vesh mirë, si për dasmë. Rrugës ikte, që të mos takonte asnjeri. Në odën e burrave e pritën mirë. Kur meshkujt e tjerë shkuan të flinin, Ramushi ndali vëllanë e Sadikut.

— Shtëpisë suaj, e ty edhe më shumë, para një viti ju ka ndodhur diçka, që i ka prekur të gjithë. Kam dëgjuar të flitet gjithçka për vrashjen e Sadikut, Njerëzit përmendin edhe emra të ndryshëm. Fjalë hallku janë ato. Unë mund të ta tregoj dorasin...

I zoti i shtëpisë u shtang. Ramushi nuk e lejonte të fliste. Nuk mund t'i besonte asaj që po dëgjonte. U ngrit dhe e mbushi stufën me dru. Pasi ofroi tabakanë, vuri dy kafe mbi stufë.

— Ne të dy do ta zgjidhim këtë çështje! — tha pas pak.

— Punë për ty! — ndërhyri Ramushi.

— Jo për mua, por për burra! — dhe i shtriu dorën. — Burrat janë si ti dhe unë! — tha.

## S H P È R B L I M I

Mehmeti, një djalosh me shtat mesatar e fytyrëkuq, rrinte ulur në rrasën e gurit dhe nuk e lëshonte fyellin nga dora. Gishtat e ushtruar ndërrohen në vrimat e tij, e pylli mbushet me një melodi të këndshme, e cila thuase do t'i konku-rojë këngës së bilbilit. Në rogë<sup>1)</sup> delet e shpër-ndara ngutshëm ndukin barin që posa ka gufuar. Janë shpérndarë ato në grupe dhe ecin në drej-time të ndryshme. Disa i janë afruar pyllit të dendur, andej nga vjen rrugica e Gunocit. Djaloshi, pa e hequr fyellin prej goje, niset pas tyre.

Kur iu afroa shpatinës, papritur një zë ia trazoi melodinë. Ktheu kokën pas, mandej në të djathtë dhe në të majtë. Nuk pa kend. Zëri u ndie përsëri, tanë më afër. «Kush mund të jetë? Sigurisht ndonjë gjahtar. Çka kërkon gjahtari tanë? Mund të jetë ndonjë fshatar duke prerë thu-pra për gardh...?»

— Djalosh, kah shkoi ai që ra këtej pak

---

1) rudinë

më parë? — ia shkëputi fijen e mendimeve një zë i panjohur. Ai e largoi fyellin nga goja dhe e shtrëngoi në duar.

— Unë nuk pashë askend.

Të panjohurit shikuani njëri-tjetrin si të thoshin se edhe ky do ta fshihte, por nuk folën. Njëri iu afroa Mehmetit. Me njérën dorë shtrëngoi pushkën, kurse me tjetrën bëri disa lëvizje të shpejta. Bariu u shtri përtokë. Hundët iu mbushën me gjak. Fyelli u përplas nëpër gurë.

— Edhe herëve të tjera mos trego të drejtën!

— u kërcënua ai nën hundë. Të gjithë humbën në pyllin e dendur. Kërkonin njeriun e panjohur për Mehmetin.

Bariu mbeti i mekur. Kur erdhi në vete, u ngrit. Me mëngën e setrës fshiu gjakun. Tani çdo gjë kishte pushuar. Fyelli strukej në cokullën<sup>1</sup>) e bukës. Delet kullotnin nëpër fier. Ndonjëra ngrinte kryet, shikonte në drejtim të pacaktuar dhe vijonte të këpuste barin e njomë. Kështu shikojnë ato zakonisht kur i frigon diçka. Kjo e frigonte edhe Mehmetin. Megjithatë, vendosi të nisej në drejtimin nga filluan të shikonin më shpesh delet. Në mes të fierit dalloi diçka të zezë. Iu afroa. Ishte një njeri i panjohur. Nuk ngrihej, vetëm bënte me dorë që t'i afrohej. Vettëm kur u bind se ai nga rrobat dhe nga sjelljan ndryshonte prej të mëparshmëve, iu afroa.

«Ky duhet të jetë ai që po kërkonin ata», — tha me vete djaloshi dhe me gjysmë zëri iu drejtua të panjohurit:

---

1) trastë

— Kush je ti? Çka kërkon në mes të pyllit?

I panjohuri buzëqeshi. Zgjati dorën dhe i përkëdheli fytyrën, në të cilën ende dallosheshin shenjat e gjakut.

— Quhem Nezir. Jam nga Malësia, — filloi të tregonte i panjohuri. — Isha edhe unë bari. Një ditë na i morën edhe delet me të cilat jetonim. Dola në mal. Vëllanë ma vranë. Në mal jemi shumë. Nga të gjitha anët. Të gjithë kemi një qëllim: Të ndjekim të huajt nga vendi ynë.

«Të gjithë kemi një qëllim», — i ushtonin në kokë Mehmetit. I përsërise edhe atëherë kur Neziri tregonte se si me hu e kishte mbytur një italian. I kishte marrë pushkën dhe bombat. Vështirë ishte t'i besoje. Teshat i ishin përgjakur. E mati të terin. «I vjen era gjak, — mendoi bariu. — Mund të jetë edhe ky si të parët. Pse atëherë e kërkojnë? Mund të flasë të vërtetën. Duhet ndihmuar. Mund të ta shpërblejë mundin ndonjëherë.»

«S'kam nevojë për shpërblime!» — thuase u frigua nga ky mendim.

«Nuk të shpërbulen me të holla, sepse nuk ka! — thoshte një zë nga brenda. — Me diçka që është më e madhe.»

Kjo diçka për Mehmetin ishte e pakuptueshme. As emrin nuk ia dinte. E shikoi edhe një herë të plagosurin. E mati nga koka gjer te këmbët.

«Ky zhelan t'i sjellë të mirën dikujt?»

Përsëri diçka nga brenda i thoshte të mos ngutej. Njeriu nuk shikohet nga veshja, por matet me zemër, me trimëri. Nën ato lecka mund të fshihet një zemër trime, zemër që rrëh kur-

doherë njësoj. Edhe para vdekjes edhe para gjëzimit. Edhe një herë, kushedi për të satën herë, e shpoi me shikime Mehmetin.

— Eja pas meje! Mund të kthehen përsëri ata që të kërkuan pak më parë. — Neziri deshi të pyeste diçka, por Mehmeti nuk i dha kohë: — Këtu afër është një shpellë guri. Pakkush e di atë. Është si shtëpi.

Era e lehtë i lëkundte gjethet e ahishtës. Ajo lëshonte një fishkëllimë që shoqërohej me tingujt e këmbanës së vetmuar në Rogën e Madhe.

Tri net kaloi i vetmuar Neziri në shpellë. Ditën lëvizte fshehtas nëpër fshatra e në mbrëmje kthehej në shpellë. Ajo i ishte bërë si varr. I dukej se po e përbinte. Do të shembeshin shkëmbinjtë e varur dhe do ta zinin të gjallë. Lidhjet me Mehmetin i kishte humbur prej tri ditësh. Asnjë lajm nga ai.

«Më ka tradhtuar? Më pati thënë se babait nuk guxonë t'i tregonte, sepse ai nuk dëshiron të përzihet në kësot punësh. I ka dertet e veta të gjallisë, të varfërisë. Sa herë të sjell bukën, atë e mashtrojnë nëna dhe motra. Thuase unë jam aq naiv. E di unë mirë se burrë e grua nuk i fshehin gjë njëri-tjetrit. Gratë si gratë. I shpëton nga goja dhe e pati puna. Edhe unë i besova shumë. I zbulova të gjitha fshehtësitë. I tregova edhe ku ndodhen tanët. Madje edhe vetë e dërgova atje. Bile, me urdhrin e tyre, sipas fjalëve të Mehmetit, unë mbeta këtu. Sa lehtë u mashtrova.

Çka po mendoj edhe unë. Me të vërtetë jam i çuditshëm! Nuk ka këtu kurrfarë çudie. Qe tri

ditë nuk ka kurrfarë lajmi. Kur shkoi ai në Qafën e Sulbicës, bukën ma sillte eëma ose e motra. Tash as ato nuk vijnë.

Pse nuk shkon në shtëpi ta vërtetosh se ç'ka ngjarë?

Mençuri, e, he bacë. Shko vetë e hyn në grackën që ta kanë përgatitur të tjerët!

Rri atëherë pra këtu këmbëkryq, të të zënë si vjedunën<sup>1)</sup> në birucë pa iu dhimbë askujt!»

U ngrit. E ndezi shkrepësen dhe iu afroa te-shave në të cilat kishte fjetur disa net. «Le t'u dalë tymi edhe këtyre. Por e fiku atë. T'i hajë dreqi. Çfarë faji më kanë këto?» — tha dhe u ul përsëri. I bënë veshët apo dëgjoi një zë? E shtrëngoi pushkën në mes të duarve. E bëri gati. Kur pa Nurijen, që nëpër terr vështirë dallohej, u skuq. Ajo buzëqeshi.

— Mos u frigo, he burrë.

— Friga e trimëria janë afër njëra-tjetrës. Nurija e shikoi dhe sytë iu mbushën me lot.

— Ta solla bukën. Nëna më dërgoi. Nezirin e ke si vëlla. Shko, se u bëmë horr me të», — më tha.

— Po. Mehmeti? — nuk iu durua Nezirit pa pyetur.

— Shtëpinë e Selmanit e kanë shndërruar në burg. Dikush e ka tradhtuar. Atje është tanë. Po flitet se e kanë munduar shumë.

— Mehmeti në burg! — u ngrit dhe filloi të ecte pa lidhje. Nuk e dinte, nga turpi që kishte dyshuar, apo pse çështja ishte ndërlikuar më shumë.

— Shko në shtëpi, — iu drejtua Nurijes. — Çka po më shikon ashtu? Ec, kur të them. Nuk kemi kohë të presim.

— Të shkoj në shtëpi! Si po ta nxe goja?!

— Si the?

— Ashtu si thashë. Si po ta nxe goja?!

— Atëherë?

— Unë kam dalë nga shtëpia të mos kthehem më. Tani po e kupton?

Si t'i ndiqte kush, dy hije dukeshin sa në një kodër në tjetrën. Cicërima e zogjve u shqëronte hapat.

Të nesërmen njerëzit nuk kishin mundur t'i dallonin purpurimat e agimit nga flaka që e kishte kapluar fshatin.

— Sa mirë po kallet burgu! — kishte thënë dikush.

— Cili burg, more? — ishte habitur tjetri.

— Sikur nuk e di. Shtëpia e Selmanit, more i marrë, — ishte tallur i pari. — Mirë ua kanë punuar.

Kasollja e Mehmetit kishte mbetur e zbrazët. Plaka kishte shkuar tek i vëllai në fshatin fqinj. Për plakun nuk dihej mirë. Dikush kishte thënë se edhe ai kishte dalë në mal. Mund të ishte e vërtetë.

— Me siguri, — kishte pohuar Mehmeti kur kishte dëgjuar. — E njoh mirë unë atë. Është si ariu kur i ngucin zogjtë. Duhet kërkuar që të mos mbajë gjajlen tonë.

— Do ta gjejmë sa më shpejt, — ishte pajtuar Neziri dhe kishtë shikuar Nurijen,

## P E R C J E L L J A

Në dhomën e Sadikut mbretëronte qetësia. Ai rrinte ulur afër oxhakut të mbushur me cungje dhe émbël, shumë émbël thithte në kamish. Drita e fitilaçit të vogël me vajguri që ndodhej në rrethin e oxhakut pasqyronte në mure hijen e shtëllungave të tymit, të cilat njëra pas tjetrës bashkoheshin me tymin e fitilaçit dhe shkonin si ndonjë re e shkëputur drejt tavanit të dhomës së vogël. Kur takoheshin lart, ktheheshin shikullave<sup>1)</sup> të ahut të punuara mjeshtërisht, por që tanë kanë marrë një ngjyrë të zezë dhe është shumë vështirë të dallohen shkronjat e gdhendura me brisk ose strug<sup>2)</sup> të mjeshtërit të kujdeshëm. E gjithë kjo nuk i bënte kurrfarë përshtypjeje Sadikut. As që e vërente. I interesonte pse i biri sonate nuk vinte në odën e burrave si qdo natë tjetër. Hëngri darkë dhe iku. Pas pak u kthyesh, e mori llambën dhe në vend të saj la këtë fitilaç, pa folur asnje fjalë. Pse bash sonate veproi

---

1) degë

2) zdrukth

kështu? Sonte, kur nuk ka as miq, e kur Sadiku ndien më tepër nevojën, më tepër se asnjetëherë tjeter, të shkëmbejë mendime me dikë, kushdo qoftë ai. Ka shkuar në dhomën e grave dhe kushtë çka përzien.

Para disa ditësh i thashë shko. Ajo tani po bëhet gati. Nesër duhet të niset për rrugë e unë ende nuk kam vendosur as kështu, as ashtu dhe, pasi e fiku cigaren, ngriti dorën e djathtë, me dy gishtat e saj e rroku plisin dhe e vuri mbi gju. Me të njëjtën dorë kruante kokën e rruar me brisk vetëm para dy ditësh. Pse i thashë shko? Pyeta shumëkend e asnjeri nuk më tha njësoj. Njëri: çoje, e tjetri: të plaqin sytë çka do të bësh! Djali e Rukija më patën qitur mendtë. E dija se djali nuk e ka kryer hala këtë shkollën e fshatit, por më thoshte për motrën e vet. Edhe ai drejtori i shkollës m'i pati marrë mendtë me fjalë të mira. Thuase i dilte mjaltë nga goja, kopilit, kur fliste.

Iu kujtua e gjithë ngjarja. Ajo më fund të vittit shkollor. Kur u tregua përfundimi i nxënësve të klasës së fundit, drejtori i ndali prindët. Bisedoi gjatë me ta:

- Ju e dini, — ia filloi ai, — se sa nevojë kemi ne për ngritjen kulturore e arsimore të të gjitha shtresave. Robërimi shekullor na la prapa...
- Edhe këto fjalë, që i kishte dëgjuar kushedi sa herë, tingëllonin ëmbël në gojën e drejtorit. Pas hyrjes ai dalngadalë kishte dalë atje ku synonte: t'i luste prindët që t'i dërgonin fëmijët në shkolla të mesme. Djem dhe vasha. Për këto të fundit foli më gjatë. Ndër të parët që i dhanë

fjalën se do të vepronin ashtu siç kishte kërkuar ai, qe Sadiku. Kur tregoi në shtëpi, fëmijët përqafuan njëri-tjetrin, kurse gruaja vetëm uli kokën dhe duke dalë përplasi derën.

«Unë nuk jam fëmijë të më mashtrojë kush, dyshoi me vete. Para se të vendosja pata biseduar edhe me vajzën. Në shkollë të mesme të mjekësisë do të shkoja, baba, më pati thënë. Të ndihmoja fshatin, fëmijët e pleqtë».

— Çka bëhesh kur ta kryesh? — kishte pyetur ky sinqerisht.

— Motër, baba. U shërbej të sëmurëve në ambulancë, në spital e kudo tjetër si Ankica e Serveti.

Pas kësaj çdo gjë m'u bë e qartë. Vajza ime do të bëhet doktoreshë. Nuk do të kem nevojë të shkoj më tek ajo Ankica. Një herë qeshë e ishallah nuk më çon zoti më. Shkova kur pata vrarë gishtin e dorës së djathtë. Mezi u mora vesh me të. Besa, as deshi të më shikonte. Zgërdhihej me një kopil, i cili tërë ditën rrinte aty. Pas do kohe thanë se shkoi. Në vend të saj kishte ardhur një tjetër. Dëgjova se ishte vajzë e mirë. Vetë nuk e njihja. Mirëpo nuk doli si patën thënë në fillim. Të hënave vonohej, e herë-herë nuk vinte fare. Ditëve të tjera në mesditë e vishte mantelin dhe nisej për në shehër, edhe pse e pritnin plot njerëz para derës. Ranë këto e unë thashë: le të shkojë. Si mund t'i ndihmoj unë më mirë fshatit, vetes pos kështu. Bija ime do të jetë në punë, edhe në shtëpi. Kur ka nevojë dikush e thérresin në mes të natës. Nuk është pak t'i ndihmosh të sëmurët.»

I silleshin në kokë këto Sadikut sonte. Pasi nuk kishte kujt t'ia thoshte, qe edhe i biri iku, ia përsëriste vetes, si të donte të bindej se a kishte vepruar mirë. Plisin e vuri në kokë. E rrudhi këmbën e shtrirë dhe e kryqoi. Nxori kutinë dhe mbështolli edhe një cigare.

«Ani a janë mend këto!? Umë i pari nga ky fshat ta dërgoj vajzën në shkollë, në shehër! Ata që i thanë drejtorit se do t'i dërgojnë, duket se e bënë këtë vetëm sa për t'i bërë qej-fin. Tani të gjithë kanë heshtur. Nuk e di që po bëjnë» Iu kujtua se kishte dëgjuar për vajzat e fshatit fqinj, të cilat që dy e më shumë vite po vijonin mësimet në qytet. «Le të jem i pari i këtij fshati, — tha me kreni në vete, — nesër të tjerët do të më kenë lakmi. — Por prapë u fri-gua. Njerëzit si njerëzit. Disa i kishin folur keq për vajzat e shkollës. — Shkojnë dhe rrinë bashkë me djem. Flasin e qeshin tërë ditën. Shejtanat i mashtrojnë. Luaje, atëherë, Sadik Kodra, mëse mund ta luash! Ndali fjalët e hallkut.»

E rroku cigaren që e kishte lënë mbi sandraçë<sup>1)</sup> dhe e pa se ajo gati ishte imbaruar e ky nuk e kishte thithur as dy herë. E thithi edhe dy herë dhe e hodhi.

I dukej vetja si ato barka në mes të valëve të tërbuara të detit, kur njëra e pehat<sup>2)</sup> në një amë e tjetra në anën tjetër për ta përplasur në ndonjë shkëmb. Qëndronte dhe pehatej pa ditur kah të rëndonte më shumë. Lopatat i kishte në dorë,

1) copë e thurur me katrorë.

2) lëkund.

por kah t'i sillte. Nuk ishtë lehtë të vendoste. Megjithatë, ky ishte ai lundërtari i barkës që nuk mund të qëndronte më kështu në mes të detit. Duhej zgjedhur bregu nga i cili lypsej drejtuar. Edhe e zgjodhi. Thirri t'i shtronin.

Me tesha në krah e shoqja, një grua e vogël, hyri krenare. I lëshoi në këndin e dhomës ku bie Sadiku.

— Pse nuk erdhi Rukija të më shtrojë? — pyeti.

— Ajo po bëhet gati. Nesër niset për rrugë, — tha gruaja dhe e shikoi me habi.

— Për ku po niset?

— Çka po flet edhe ti, allahile?!

— Për ku po niset, po të pyes?

— Ti e di më mirë se unë. Dje vetë i ke thënë, — tha ajo me habi. Nuk e dinte se po tallej apo fliste seriozisht Sadiku.

— Shtroji teshat dhe mos e zgjat shumë. Nesër e merr vesh se a do të niset ajo, — tha prerë.

Në dhomën e grave kishte shpërthyer vaji. Rukija nuk e kishte pritur këtë. As Sadiku nuk flinte. Ishte shtrirë dhe shikonte në tavan njëpër terr. I biri kishte ardhur dhe ngadalë kishte hyrë nën jorgan pranë të atit. Sadiku kthehej sa në njërin sa në tjetrin krah. Ngrihej, mbështillte cigaren dhe, pasi e ndizte, shtrihej përsëri. Diskur vonë, shumë vonë e kishte mashtruar gjumi.

Një thineshë<sup>1)</sup> e vogël i afrohej gjithnjë e më shumë. Ky disi e donte atë thineshë, por diçka që as vetë nuk dinte ç'ishte, e pengonte ta

prekte. Thinesha i afrohej e ky përpinqej të langohej nga ajo. «Po të preku, ta prish fenë!», — i tha dikush, një zë që nuk e dallonte se i kujt ishte dhe nga i vinte. Thinesha i afrohej si të kërkonte mëshirë nga ai. Kur iu afrua, ai mori një hu dhe i ra pas kokës. Sa gjerë-gjatë u shtri gjallesa përtokë. U shndërrua në njeri, në vajzë. Sadiku bërtiti. U zgjua nga gjumi. Dhoma ishte e errët. I biri flinte pas shpinës së tij. E ndezi edhe një cigare. Nuk besonte se ajo që kishte ngjarë pak më parë kishte qenë ëndërr. U ngrit ngadalë, iu afrrua derës ku flinte e shoqja me të bijën. Vuri syrin në vrimën e çelësit. Nuk shihte asgjë. Nga brenda dëgjohej gërhitja e së shoqes. Vajza lëvizi të ëmën. E thirri dhe qetësia e natës së errët vazhdonte. Sadiku u kthyte në dhomën e vet dhe u shtri pranë të birit.

«Kjo është shenjë gjynahu. Por, pse ajo m'u duk si thineshë? Besa nuk e dalloja mirë. Kush dreqi qe ai që më foli? Unë i besova. E mbyta, e mbyta Rukjen. Babai të bijën!» — thithi cigaren dhe u kthyte nga i biri. Ai flinte i qetë. Ia lëmoi ftyrën dhe nuk dinte çka të bënte. Ta zgjonte apo ta linte të flinte? U ngrit edhe një herë. Doli nga dhoma. Iu afrua odës ku flinin e shoqja dhe e bija. U mat të hynte brenda, por u ndal. Sillej nëpër korridór pa ditur çka të bënte. Dikur u kthyte përsëri dhe u shtri.

Gjynah! Çka është gjynah? Hoxha thotë se gjynah është të thuash se doktori di më shumë se hoxha... lëvizi kokën me habi. Sa larg kanë shkuar këta hoxhallarët tanë! Nejse. Po pse qenka gjynah të dalë femra pa havale!? Kur isha i vogël,

me vajzat e fshatit, me ato të rriturat i ruaja qen-gjat. Me shtat ato ishin më të mëdha se nëna ime. Nuk fliste askush keq për to. Edhe ato luanin me djem, me djemtë e fshatit tonë dhe të atij fqinj. Sadiku edhe një herë e lëvizi kokën dhe lëshoi një zë, si të fliste me dikë: «Kush dreqi i shpiku këto?»

Nyja e perit të mendimeve të tij ishte lidhur me gjynahun:

«Çka është me të vërtetë gjynahu?» — e mundonte atë tanë. «A ka gjynah më të madh se t'i prishësh qejfin njeriut? — nuk i erdhi mirë që i bëri vetes këtë pyetje. Ndoshta pse mu vetë sonte kishte prishur disa qejfe «Nuk është mirë, në mos qoftë gjynah edhe t'i ndërrosh fjalët. Burri lidhet për fjale e jo për huri», iu kujtua urtia popullore. Nuk i pëlqente as kjo urti, por disi i dukej e qëlluar. Nuk i pëlqente, ndoshta mu pse ajo do ta nxirrte diçka tjetër, nga ç'ishte, nga ç'mendonte se ishte. «Më mirë të mos mendoj për asgjë!» — i tha vetes dhe u shtri të flinte.

Të nesërmen në mëngjesin e hershëm, në rrugën automobilistike, në stacionin e autobusëve në fshat, prinin tre veta. Autobusi i parë u ndal. Një burrë i gjatë, veshur me tirq të bardhë, që shndritin si bora e bjeshkës, me valixhe në dorë u afroa te dera e autobusit që u hap. Ia zgjati konduktorit valixhen dhe përqafoi të bijën. Rrotat e autobusit u sollën mbi asfalt. Baba e bir e shikuan atë, gjersa u zhduk pas bregores së vogël.

## K T H I M I

Veriu, thuase e kishte burimin në Bjeshkët e Nëmuna, mu në majën e Gjeravicës, që tani nuk dukej prej mjegullave, përplasej në çatinë e ndërtuesës së vogël dhe të vetmuar të stacionit të autobusëve në një kënd të fshatit. Brenda, në një sallë të vogël, zhurma i bënte konkurrencë veriut të tërbuar. Aty nuk kishte shumë njerëz, por as ata nuk rrinin të qetë. Dy aty në mes janë ulur në karrige dhe këndojnë. Rreth tyre dendësia është më e madhe. Një djalosh këmbëzbathur me një shportë në dorë endet duke thirrur: «Bonbone, bonbone! Urdhëroni, të mira e të lira!» Kjo nuk u bën kurrfarë përshtypjeje atyre dy plakave të ulura në karrigen e vetmuar. Ato pandarë shikojnë atë gruan e re me fëmijë ndër duar, që nuk pushon së qari, edhë pse e ëma endet dhe kot mundohet ta gënjejë. Plakat nuk njihen në mes tyre. Janë ulur afér njëra-tjetrës, shikojnë gruan e re, e mandej njëra-tjetrën. Dikur ia shkrep Shakja:

— Vështirë është të marrësh rrugë me fëmijë të vegjël!

— Vështirë, por çka t'i bësh dertit! — tha plaka e kërrusur dhe me gungë në shpinë, duke dashur ta arsyetonte nusen.

Ato shikojnë përsëri njëra-tjetrën. Plaka me gungë ul kokën dhe shikon karrigen, të cilën fëmija e kishte gdhendur me brisk. Shakja nuk ia ndan sytë nuses, e cila duket se turpërohet përvajin e fëmijës nga njerëzit e panjohur. Kur shikon atë, i kujtohet Nurija. Duhet të vijë nga çasti në çast me fëmijë të vogël.

Boria e autobusit ndërpreu çdo mendim, këngë e hare. Turma e njerëzve sulmon derën e ngushëtë si delet gjolin e kripës.

Shakja nuk ia ndan sytë derës së autobusit, që ka qëndruar. Shikon secilin udhëtar. Një plakë me shtage<sup>1</sup>) në dorë, që shtyu konduktorin, i cili thërrret: «Mos u ngutni! Ka vende mjaft! Tani vjen tjetri», — mundohet të rregullojë gjendjen në autobus. Kjo e pengoi Shaken që t'i shihte mirë të gjithë udhëtarët. Nuk i mbeti tjetër, pos të vraponte dhe të zinte derën e gjerë të oborrit të rrethuar, prej nga shkonte rruga për në fshat. Priti gjersa kaluan të gjithë. E dëshiruar u kthyte përsëri në vendin ku rrinte më parë.

«Ndoshta nuk do të vijë! Turpërohet! Eja, bija ime, eja! Nuk është turp. Besa, edhe unë pa pikë qejfi e kam gënjer babanë tënd. Por, atëherë ndryshe ishte koha. Tani mund të vish lirisht. Shumë jemi përmalluar për ty», dhe, ndërsa kishte ulur kokën, pa në pluhurin përpëra pikat e lotëve. Ishin të sajat.

---

1) shkop

— Edhe ti mbete, a? — pyeti plaka me gungë duke u ulur.

— Paj po përcjell këtë milet, — u mahit Shakja si padashur. Ktheu kokën në anën tjetër dhe fshiu lotët. — Po pres vajzën. Nuk e kam parë katër vjet, — tha mandej...

— Ku është? — pyeti plaka me gungë.

— Ti po pret dikë apo deshe të udhëtosh? — pyeti përsëri Shakja si të donte t'i ikte përgjigjes, e cila preku plagën e kahmotshme që kishte filluar të shërohej. Më kot Shakja donte t'i ikte bisedës për të bijën. Plaka me gungë, pasi i dha përgjigjen, e pyeti disa herë atë për vajzën që duhej të vinte.

\* \* \*

Kishin kaluar katër vjet nga koha kur Ramizi rrinte kryeulur në mesin e burrave të fshatit, që atëherë kur iku Nurija. Ngjau kjo atë natë vjesh-te, dy javë para se të shkonte te burri. Një gjë e tillë për herë të parë po ngjante në këtë fshat. Si ta shpjegonte para burrave. E dinte mirë, e këtë e kishin ruajtur bashkë qengjat disa vjet. Si mund të ngjasë kjo? Vajza e fshatit të martohej me djalin e të njëjtit fshat — që të dy të një fisi! Vajza e dhënë për dikë tjetër! Vërtet çudi!

— Ju i keni fajet, — qe hidhëruar Ramizi me të shoqen dhe të birin. E shoqja, më shumë qe dëshpëruar kur dëgjoi për fejesën e Nurijes, sesa kur iku. E për Rexhepin kishte të drejtë të dy-shonte. Shpesh, veçanërisht kohët e fundit, e shih-

te në shoqëri me atë kopilin jetim të Sasikut, me atë që i mori motrën për grua.

Edhe pse Ramizi gati sa nuk pëlciste nga inati, Shakja e Rexhepi asnjëherë nuk bisedonin me të. Atëherë ai, gjoja për të mbuluar turpin, u largua nga shtëpia.

Brenda gjashtë muajsh në fshat ndodhën edhe shumë «çudira» të tjera. Gati të gjitha vajzat e rritura, veçanërisht ato që ndiqnin atë kursin, u martuan pa dëshirën e prindërve.

«Bie një e harrohen të tjerat», e pati arsyetuar veten Ramizi dhe me zemër të thyer qe kthyer në shtëpi, sepse dyerve të hallkut nuk rrihej.

Të gjitha këto i kujtoheshin atij atë natë kur rrinte shtrirë dhe pushonte në dhomë. Nxori një kashtë nën cergë dhe filloi të ngacmonte dhëmbin e brejtur.

«Vajzë e kam. E gjakut tim. Çdo gjë do të bëja ta shihja një herë, të dëgjoja për të. Baba, si baba. I fal shumë sende fëmijës së vet. Si më erdhi mua ky mendim tanë. Mendimi i çuditshëm. Ajo ma mori fytyrën e tanë kërkoj ta shoh», — dhe u ndal. Iu kujtuan edhe vajzat e tjera që u martuan kundër zakoneve e shariatit (ashtu siç ia kishte shpjeguar hoxha këtij shariatin).

«Unë u mundova për të mirën e saj. I zgjodha shtëpinë më të mirë. Burrin as vetë nuk e njihja. Më patën thënë se është i mirë. Po tek e fundit burri nuk prish punë.

Kryesore sot është të jetë i shtëpisë së mirë. Le të ketë pasuri. Kanë ndryshuar gjërat, or Ramiz. Tjetër këngë po këndohet tanë. U ngute ti atëherë. Nuk pyete askend. As gruan. Edhe e saja ishte

vajza», — dhe i tingëlluan në vesh fjalët e hoxhës, se kush e dëgjon gruan nuk është turk. Kështu disi thoshte ai: «Ato, femrat, i ka krijuar zoti për hatër të mashkullit.» «Nuk e pyeta as vajzën. Kushedi se çka do të thoshte ajo vetë.»

Hoxha e burrëria ishin lidhur njëra me tjetrën e Ramizi nuk mund t'i ndante. Dikur hoxha, i cili flet herë kështu e herë ashtu, u tret në mjegullën e dendur të pluhurit që u duk kur u hap dera e dhomës dhe brenda mbeti vetëm burrëria.

Çka është burrëri. Ta falësh të ligën. Si ata djemtë e shtëpisë, ku pata dhënë Nurijen. Kur u vdiq axha, ai dhëndri, vërtet kishte qenë burrë i mirë, erdhi vetë. «Mik i mirë, miq ishim e miq do të mbetemi. Për ne vajza jote është e lirë. Kjo është burrëri. Nuk i them unë, por e gjithë bota».

Dera u hap përsëri. Ai pa të birin që në këtë ditë shiu gdhendte me strugë do dérrasa në korridor. Para derës ishin grumbulluar gdhendlat, që lëshonin pluhur. E shikoi Rexhepin.

«Ti! — i dukej se i thoshte dikush. Ti, kur erdhe, nuk fole as me Rexhepin. Nuk ishte i vogël atëherë.

A thua unë apo ky jemi fajtorë që iku Nurija! Ti vendos për fatin e huaj...»

Dhe prapë burrëria. «Burrëria mbulon turpin». U gëzua për këtë zbulim, për diçka që nuk i ishte kujtuar gjer tanë.

— Rexhep, o Rexhep, thirrma nënën tënde!

Shakja, e habitur hyri në dhomë. Ramizi i foli butë, më butë se asnjëherë më parë.

— A është turp të kthehet Nurija?

— Cfarë turpi? — tha gruaja më shumë nga gëzimi, sesa që kishte menduar shumë.

— Nuk është turp ta thërresim ne?

— Jo turp, por njerëzi, burräri, — tha gruaja, e bindur se kishte triumfuar.

— Rexhep, o Rexhep! — thirri përsëri Ramizi.

Djaloshi hapi derën. Nuk hyri në dhomë, por vetëm i dha shenjë se e kishte dëgjuar.

— Mos e di ku është Nurija?

Rexhepi rrudhi krahët. Kjo e bëri nervoz Ramizin. Nuk donte të fliste me zë të lartë. Sepse çdo gjë do të merrte kahje tjetër nga ajo që ky kishte menduar.

— Çka po ngurron? Nëse e di, shkruaji. I thuaj se unë po i lutem të kthehet. Falë i qofshin të gjitha. Tregoi për të gjitha. E mos harro ta thërresësh bashkë me të shoqin në shtëpinë tonë, për disa ditë! — zëri i ndalej gjithnjë e më shumë.

Atë ditë, për herë të parë, me dijen e prindërve, Rexhepi i kishte shkruar shumë shkurt dhëndrit. I kishte ftuar të vinin.

\*

\* \* \*

Këtë, në mënyrën e vet e tregoi Shakja, ndërsa plaka me gungë ishte bërë vesh. Kur e kreua, nuk iu durua pa thënë:

— Ndryshe ishin kohërat kur u martuam ne, oj motë!

Boria e autobusit u dëgjua përsëri. Shakja nuk pati kohë të thoshte më gjë. As vetë nuk e dinte si u gjet bri rrugës.

Kur u hap dera e autobusit, një grua e veshur qytetarçe, me një fëmijë për dore, e zuri të tërën.

Pas saj shkontakte një djalosh i pashëm me dy valixhe në duar.

«A është Nurija kjo?»

Shakja nuk u besonte syve.

— Nënë! — thirri ajo dhe u zhgreh në vaj.

Pasi u përshëndet me dhëndrin, Shakja e mori nippin para duarsh dhe u nis për në shtëpi.

Në mbrëmje vajzat ia thanë këngës të përcjella me def. Nuk dihej a ishte dasmë apo kanaxheç.<sup>1)</sup>

---

1) dasmë në shtëpinë e nuses

## P R E M T I M I

Njëra nga gjethet e shumta, që puhia e lehtë i shkundte prej degëve, pasi bëri një hark në hapësirë, ra në këndin e karriges ku rrinin dy të rintjtë. Djaloshi, si ta kishte penguar, e la librin dhe me majë të gishtërinjve rrroku gjethin. Filloi ta shikonte disi me dhimbje, ani pse as vetë nuk e dinte çka e kishte prekur më shumë në këtë rast. Maja e tij e gjelbër i kujtoi pranverën, atëherë kur ky bashkë me shumë të tjera posa kishin dalë dhe i kishin dhënë natyrës një pamje tjetër, të mrekullueshme. E qe, tani vjeshta e pamëshirshme po i treste, thuase donte të pastronte vendin e borës që do të binte ditët e para të dimrit. Pranvera përsëri do të vijë me gjethë dhe lule të reja, që do të dalin mu në këto degë dhe në fushë. Pranvera e lumtur. Sa e lumtur do të ishte sikur të mos vinte vjeshta.

«E tërë kjo i ngjan jetës së njeriut» — tha me vete djaloshi, thuase zbuloi diçka dhe përsëri e shikonte gjethin.

— Pse e ndërpreve leximin, Shpëtim? — ia kë-puti fillin e mendimeve vajza, e cila qëndronte pranë tij dhe priste që ai t'i jepte fund leximit të kësaj

njësie mietodike mbi luftërat e kryqëzatave. Ai e shikoi habitshëm dhe e mati të tërën nga koka në këmbë. Blejt e flokut, që duke mbuluar njëren vetull të zezë i ishin lëshuar fytyrës rrumbullake, asaj i jepnin një bukuri që ky rrallëherë e kishte parë. Ndoshta, mu kjo nuk e lejoi ta përsëriste përgjigjen e rëndomtë në pyetje të këtilla. Prandaj vendosi t'i tregonte gjithë atë që i ishte kujtar në këtë çast. Nuk harroi ta krahasonte pranverën me rininë që ikën shumë shpejt dhe vjeshtën me pleqerinë, me pleqerinë që askush nuk e do.

Vajza buzëqeshi.

— Sa krahasim me vend, — tha ajo pas pak. — Disa herë kam menduar se me të vërtetë rinia kalon si pranvera. Kalon dhe nuk kthehet. Vjen tjetra, vërtet, por atëherë shumë gjëra kanë ndryshuar. Ndryshojmë edhe ne, që ende nuk njihemi mirë në mes nesh. Unë, bie fjala, që sa kohë shoqërohem me ty dhe ende nuk di a dashuron ti ndonjë femër.

Kjo mënyrë dhe ky çast i ishte dukur Shpresës më i miri për t'ia thënë Shpëtimit atë që e ruante si të fshehtë prej ditës së parë që kishin filluar të mësonin orëve të pasdites nën hijen e lisave të këtij pylli.

Djaloshi u skuq. Nuk e kishte pritur këtë.

— Sa qesharake je, Shpresa, — i tha ai. — Qe sa kohë shoqërohem bashkë dhe bën pyetje të tillë. Ndoshta faji është imi, që nuk të kam treguar më parë se vajza që më pëlqen mua është shumë afër.

Lugina e Gërmisë e përbiu gënjeshtërën, ndërsa e vërteta rrinte struktur diku në shpellat e shkëmbinjve të Gjeravicës, atje ku Shpëtimi e Hatixhja, një vajzë fshati që sapo i kishte kapur të gjashtë-

mbëdhjetat dhe që atë vit kishte kryer tetëvjeçaren, strukeshin nga rigat e shiut, ndërsa delet më po shtë kullotnin. Atje ku ishin këmbyer disa shikime shpeshherë dhe pikat e shiut e kishin shoqëruar këtë bisedë.

— Shpëtim, a di çka?

— Çka, Hatixhe?

— Sa emër të bukur ke, Shpëtim! Por nuk e di a je me të vërtetë Shpëtim apo vetëm emrin ke!

— Nuk po të kuptoj, Hatixhe!

— A e di çka, Shpëtim?

— Fol!

Ajo që duhej thënë tash ishte më e rëndë se shkëmbi që u qëndronte mbi kokë. Të paktën këshfu i dukej asaj.

— Shpëtim... ti e di se unë nuk e... dua atë me të cilin më kanë fejuar. Ti je shpresat ime e fundit.

Ajo uli kokën dhe shkëmbi ku e kishte drejtuar shikimin ishte lagur. Ky nuk dinte si të vepronte. Në rrasën e gurit iu duk se po lexonte fjalët e profesorit kujdestar, të cilat i kishte shënuar në bllok: «Detyra e mësuesit është shumë e komplikuar: detyrë që kërkon sakrifica të shumta në kushtet tona, kur duhet bërë përpjekje jo vetëm për edukimin e fëmijëve, por edhe për nxjerrjen e femrave nga pozita e vështirë shoqërore. Të gjitha këto arrihen më së miri me shembuj dhe sakrifica personale».

E shikoi kushedi për të satën herë. Ajo tanimë e kishte paluar kokën pas gurit dhe dëneste. Nuk fliste gjë.

«Kur të kualifikohesh mund ta dërgosh në ndonjë shkollë dyvjeçare, apo edhe tani është mirë të

interesohesh për fatin e saj. Shpëtoje!» — i thoshte diçka nga brenda.

Me dorën e djathëtë ia ngriti kokën dhe e mbu-loi me të puthura. Kjo ishte përgjigjja që kërkonte Hatixhja në këtë çast.

Këtë të vërtetë që e ruanin shkëmbinjtë, Shpëtimi dukej se e kishte hedhur në harresë, ndoshta vetëm për një çast. Ndoshta vetëm tani, kur atë e udhëhiqte diçka tjetër, e jo arsyeh.

— Sa i paturpshëm je! — tha Shpresa dhe buza i shkrepit në gaz.

— Nuk mund ta fsheh atë që e ndie!

Zogjtë e vetmuar ishin të vetmit dëshmitarë të asaj që kishte ndodhur mandej në karrige, ku pak më parë kishte rënë gjethi i zverdhur.

Pranvera përsëri kishte sjellë gjelbërimin, këngën dhe gjëzimin. Fusha e gjerë i tërhiqte nxënësit grupe-grupe të treteshin në pyllin e Gërmisë.

Shpresa dhe Shpëtimi ishin ulur nën hijen e arrës së madhe. Ajo lexonte, kurse ky dukej se po e dëgjonte me kujdesin më të madh. «Lehtë është të mashtrosh», i sillej ndër mend: «Veçmas kur nuk të njeh mirë, si Shpresa mua.»

— Shpëtim, a po kupton?

— Shumë mirë, Shpresa.

Ajo vazhdonte të lexonte. Këtij i silleshin mendime e skena të ndryshme në kokë. Dikur vonë u nisën nga shtëpia e nxënësve ku banonin.

— Ty të kam çdo gjë, Shpëtim!

— Detyra e mësuesit për ne është luftë me prapambetjen e fshatit, Shpresë!

— Çfarë lidhjeje ka kjo me dashurinë tonë?

— Vajzat e fshatit duhen shpëtuar nga...

— Tani tē kuptova. Dyshoja pse po sillesh aq  
ftohtë me muq. Tē gjitha i kam tē qarta tash... 

— Tē lutem, më fal, Shpresa! — tha ai dhe,  
kur filloi t'i tregonte tē vërtetë, ajo vrapoi.

Kur arritën në oborrin e shtëpisë së nxënësve,  
njëri pas tjetrit, zilja për darkë kishte rënë.

## VAJZA E FAQES SË PARË

E lexoi edhe një herë pasuesin e parafundit të dorëshkrimit më të ri dhe nuk i pëlqeu mbarështri-mi i mendimeve. U përpoq të gjente shprehjet më të mira, por kot. Ishte lodhur. La makinën e shkrimit mbi tavolinë dhe filloi të ecte nëpër dhomë. Kur iu afrua raftit në të cilin ruante revistat e vjetra, u ndal. Zgjati dorën dhe mori disa sosh. Nuk i shikoi fare të ç'viti ishin. U shtri në kanape dhe filloi t'i shfletonte. As vetë nuk e dinte çka kërkonte. Kështu vepronte shpesh. Kur lodhej, shfletonte revista të ilustruara, thuase në këtë mënyrë glodhej më së miri. Vërtet, numri i revistave të ilustruara që ruante nuk ishte i madh. Në një kënd të dhomës kishte paluar disa sosh, ato në të cilat i ishin botuar punimet e para. Në fillim shkruante vargje. Kur i btoheshin, gëzohej si ndonjë fëmijë. I dukeshin të bukura. Tani ishte bindur se ato nuk kishin ndonjë vlerë. Po të vlenin, me siguri do t'i tubonte në ndonjë libër, siç kishin vepruar edhe disa të tjera, që më vonë nuk kishin shkruar poezi pos atyre të botuara në libër. Megjithatë,

vjershat e para i lexonte herë pas here. Ndoshta pse i kujtonin ditët e kaluara, kur nuk e ndiente lo-dhjen si tani. Ashtu i shtrirë shfletonte revistat. Herë pas here ndalej në ndonjë artikull, fotografi apo vjershë. Kur në faqet e mesme të një numri pa emrin e vet, u ndal më shumë. E lexoi disa herë vjershën, të cilën ia kishte kushtuar të atit. Si asnjëherë më parë, kësaj radhe i pëlqeu. Ishte një prej atyre vjershave të veta që i pëlqente. E lexoi disa herë dhe mandej e ktheu faqen e parë të revistës për të parë numrin, sepse viti i kujtohej. Si të mos i kujtohej, kur në ditët që kishte dalë revista kishte ngjarë diçka që e kishte tronditur shumë. Nga fshati kishte marrë telegramin: «Axha vdiq. Varrimi bëhet sot». Axhën e kishte dashur njësoj si të atin. Ndoshta edhe më shumë. Kur ishte i vogël ai e mbante pas vetes edhe në odën e burrave. Nuk dinte pse ishte pikëlluar më shumë: pse kishte vdekur ai, apo pse kishte humbur jetën tragjikisht. Kishte rënë nga dega e qershisë së vjetër në shkëmb.

Nuk e shikoi fare numrin e revistës. Në tërë faqen e parë kishte fotografinë e një vajze që bu-zëqeshte, flokët e së cilës binin gjer në bel. Kamera e fotoreporterit e kishte zënë atë në mes të luleve, shenjë pranvere. Në moshën e luleve vajza duukej edhe më e bukur. Kërkoi legjendën e fotografisë. Nuk e gjeti as në faqen e dytë, ku zakonisht shënohej. E shfletoi revistën fund e krye e askund asnjë fjälë për vajzën. Pse, vallë, nuk e kishin shënuar emrin e saj? Në raste të këtilla shënohet se pse akcili po dilte në këtë faqe. As kjo nuk ishte anonime. Vërtet, ishte e bukur, së paku kështu i dukej këtij, por nuk besonte se fotografia e saj në

faqen e parë kishte dalë vetëm për bukurinë, që ia shtonte edhe më shumë buzëqeshja me çukat që i formoheshin në faqe. Kishte diçka karakteristike në jetën e saj në kohën kur kishte dalë ky numër i revistës. Ajo ishte njëra ndër vajzat e para të fshatit që ojmet i zëvendësuan me laps e libër në shkolla të mesme. U fol mjaft për to. Fjalët i mori era. Si nuk e kishte theksuar fotoreporteri me dy-tri fjalë këtë element!? Si nuk i kishte shkuar ndër mend redaktorit të kërkonte të shkruhej një reportazh!? Ishte ky vërtet një lëshim profesional i tyre. As këtij, kur ishte botuar fotografia, nuk i kishte bërë përshtypje ky lëshim ngaqë njihte atë. I dukej se vetë fotografia thoshte mjaft. Ajo vërtet thoshte për ata që e njihnin, por çka do të kenë thënë lexuesit e tjerë?

Vajzën e njihte. Që të dy kishin qenë nxënës të së njëjtës shkollë. Ishte regjistruar disa vite më vonë. Ajo qe regjistruar me disa shoqe të të njëjtit fshat dhe njerëzit, si njerëzit e meseve tonë që hanë bukën e vet e bajnë dertin e huaj, kishin folur mjaft. Ato i vazhdonin mësimet. Këto fjalë i kishin bërë më të njoitura se vajzat e tjera.

Vitet kishin kaluar. Ky kishte vazhduar studimet e ajo ishte larguar nga qyteti. Arsyet e largimit nuk i dinte. Kur e kishte harruar fare, e kishte takuar rastësisht në qytetin ku jetonte e punonte ky, pas disa vitesh. Kur e kishte përvendetur, ajo ishte ndalur. E kishte takuar edhe disa herë të tjera. Diçka e shtynte të dilte në rrugë në kohën kur ajo duhej të kalonte në të kthyer nga puna. Dhe ajo, sa herë e takonte, ndalej. Një ditë kishin biseduar gjatë në rrugë. Më vonë ai e ki-

shtet ftuar të pinin kafe në hotelin kryesor. Duket se ajo këtë e kishte pritur edhe më parë.

E shikoi edhe një herë fotografinë. Buzëqeshja i dukej se zbulonte gjithë singjeritetin dhe naivitetin e saj në të njëjtën kohë. Një buzëqeshje të tillë rrallë e kishte vërejtur në ditët e mëvonshme. Tani iu kujtua se në një bisedë ajo i kishte thënë diçka që këtë e kishte shtyrë të interesohet edhe më shumë. Në atë kohë i interesonte të dinte çdo gjë për të. Shumë gjëra i kishte treguar ajo vetë. Në fillim ishte habitur, por më vonë e kishte kuptuar arsyen e atyre rrëfimeve. E tani i vinte keq që dinte aq shumë. Çka dreqin e kishte shtyrë të interesohet? E kishte të qartë edhe pse tani mungonte ajo buzëqeshja e fotografisë. Vitet kishin bërrë të vetën. Por brengat e jetës ishin edhe më të rënda. Iu kujtua se në një rast kishin biseduar edhe për këtë fotografi.

— Pa më pyetur fare, profesori i kimisë më dha notë kaluese! — kishte thënë ajo.

— I paske parë hairin! — ishte tallur ky.

— Ndoshta më shumë sherrin, — dhe ishte vrenjtur në fytyrë.

Vallë, pse, kishte menduar ky, por nuk e kishte pyetur. Vetëm e kishte shikuar drejt në sy. Nuk i kujtohej çka kishte menduar me atë rast.

— Revista ishte shpërndarë në të gjitha anët, — kishte vazhduar ajo pas një heshtjeje. — Mua më ishte bërë qejfi. Të vish nga fshati, ku nuk të njeh askush dhe të dalësh në faqen e parë të një reviste që kishte shumë lexues, nuk ishte gjë e vogël. Kështu më dukej atëherë. Nuk kisha menduar më gjatë se a do të duhej të dilja më unë.

— Mandej? — kishte ndërhyrë ky.

Ajo e kishte shikuar një kohë të gjatë. I ishte dukur se donte t'i thoshte se pse po e shqetësonë, pse nuk po e linte të qetë, por nuk kishte folur. Mandej i ishte mbushur mendja se, kur njeriu e rrëfen të njëjtën gjë disa herë, i duket sikur lirohet nga diçka që e mundon. Ajo e kishte hetuar se hesh-tja e saj e kishte shqetësuar këtë. Kishte buzëqeshur.

— Po të fton njëri nga fshati yt, më tha një shoqe kur po rrinim në dhomën e konviktit të nxë-nësve, — kishte vazhduar ajo pas pak. — Kush mund të jetë, mendova? Çka ka ndodhur në familje? Unë dje sa erdha. Megjithatë nuk më kërkon dot. Ndoshta është ndonjë që, duke kaluar këndeje pari, është ndalur të më shohë. Me këso mendimesh dola në oborr. Para vetes pashë një njeri dyzetecavjeçar, që më shikonte disi habitshëm. Më dukej se e njihja, por nuk isha e sigurt. «Rasimi jam, nuk po më njeh?»

Rasimi vërtet ishte fshatari ynë. Nuk e njihja mirë, sepse nuk e kisha parë shumë herë. A di si është: vajzat e fshatit nuk dalin nga shtëpia. E pyeta pér të gjithë. Me gjakftohtësinë më të madhe m'u përgjigj. Dinte çdo gjë pér familjen tonë. Kjo më bindi se vërtet ishte Rasimi.

— E kam vështirë të ta them, por më duhet! — tha ai.

— Fol, — u bëra kureshtare.

— Nënën e ke të sëmurë. Nuk është shumë, por të kërkon. Kam ardhur të të marr.

U shtanga në vend. Një ditë më parë ishte

shumë mirë. Çka mund t'i kishte ndodhur? Sikur të mos ishte sëmurë, nuk do të vinte!

— Ngutu, se na ikën treni! — tha kur më pa të habitur. — Nuk është aq e sëmurë, të thashë edhe një herë.

— T'i tregoj Zades dhe erdha. Ndoshta vjen edhe ajo me mua.

— Çka po të duhet!? — u habit ai. U ktheva në dhomë dhe bashkë me Zaden u përgatitëm shpejt e shpejt. Kur dolëm të dyja, atë të thuash e kishte lëshuar tokë. E kërkuam në të gjitha anët, por kot. U kthyem në dhomë.

— Kush ishte ai? — kishte pyetur ky, pasi i kishte treguar se atë natë nuk kishte fjetur fare.

— Nuk ka rëndësi kush ishte, po pse kishte ardhur.

Heshtja e rëndë e kishte mbuluar tavolinën pranë së cilës po rrin. Ai nuk dinte çka të thoshte. I interesonte të dinte pse kishte ardhur. Ajo heshtte. Ndoshta priste ndërhyrjen e këtij. Rroku filxhanin e kafes, të cilin e kishte kthyer, dhe filloita shikonte. Kur ky i ishte përgjigjur se nuk u besonte atyre që flasin gjoja se po e tregonin fatin sipas filxhanit, ajo kishte qeshur, e këtij i ishte mbushur mendja se as ajo nuk besonte. Por i ishte bërë shprehi ta kthente gjithmonë dhe ta shikonte ashtu vetë.

— Me siguri nuk kishte ardhur me ndonjë qëllim të mirë? — kishte pyetur ky dikur.

Ajo e kishte lënë filxhanin dhe me dorën e djathtë e kishte larguar bleun e flokëve që i kishte mbuluar syrin. I kishte treguar se e kishin fejuar, posa kishin parë fotografinë. I fejuari e kishte dër-

guar atë ta rrëmbente, duke e mashtruar në këtë mënyrë. Kur e kishte parë me Zaden, ai ishte bindur se do ta njihnin dhe ishte zhdukur. Ndoshta kishte menduar se do të gjente ndonjë rast më të mirë.

— Fejesa ishte bërë me lejen e prindërve?! — e kishte pyetur ky i habitur. Si kishin mundur ta bënin një gjë të këtillë prindërit, që vetë e kishin dërguar në shkollë?

— Ata më vonë e kishin kuptuar. As sot e kësaj dite nuk e di se a ishin pajtuar me këtë. Nuk kisha guxim t'i pyesja. Mund të zhgënjevesha.

— Si ashtu?! — ishte habitur ky.

Ajo kishte treguar se një i afërt i saj ishte shok me njërin nga ata që ato ditë «vranin e kthjellnin» në fshat. Këta e kishin kurdisur planin. Si kishte reaguar i ati dhe çka kishte bërë ai, kjo nuk e dinte. Ndoshta edhe dinte, por nuk fliste. Nuk iu përgjigj as pyetjes së drejtpërdrejtë që i bëri ky. Në vend të saj tregoi se si ai, kur e kishte përcjellë për herë të parë për në shkollë të mesme, në njëfarë mënyre i kishte thënë se vetë do të duhej të vendoste për fatin e saj. A është e mundur të ketë ndërruar kaq shpejt bindjet?

— Si u bë mandej? — ishte bërë kureshtar ky të dinte përfundimin e kësaj ngjarjeje.

— Gati u martova me një tjeter! — kishte thënë ajo pas një heshtjeje. — As vetë nuk e di se a e kam dashur vërtet apo për inat.

Ky e kishte shikuar me një kureshtje të posaçme. Njëherë i kishte shkuar mendja se kishin të bënin me një njeri që nuk i mat sa duhet veprimet e veta, përndryshe si mund të vepronte ashtu. Mos vallë është nga ata që e kanë përvetësuar verbë-

t'ia thoshte të kundërtën: se ai nuk ishte për atë. Këtë mund t'ia ketë thënë dhe asaj në njëfarë mënyre. Kjo mund të ishte, sipas tij, mënyra më e mirë që ta ftohte njërin nga tjetri. Arsyen e vërtetë në fillim as që e dinte. Ndoshta nuk i pëlqente ky si njeri. Mund të kishte edhe arsyen e tjetra. Motra e tij me një rast, në mënyrë të tërthortë, i kishte thënë se nuk i pëlqente, por ky nuk ia kishte vënë veshin. Nuk i kishte bërë përshtypje as po himi i saj se këtij i kishte kaluar mosha e martesës, e as kur i kishte bërë vërejtje se nuk ishte aq pendant, edhe pse askush tjetër nuk ia kishte thënë këto, veçmas këtë të fundit.

Dhe i ishte kujtarë Mona. Atë e njihte tërë qyteti. Flitej, e çka nuk flitej për të. Thoshin njërezit se i ndërronte shpesh meshkujt. Edhe këtij i ishte dukur femër e lirë, por as që ishte interesuar t'i vërtetonte të gjitha ato që kishte dëgjuar përtë. Madje, as që ua kishte vënë veshin fjalëve. Mirepo, kur disa herë e kishte parë atë në shoqëri me Monën, kishte ndryshuar. Ishte bindur se nuk flitej kot për të. Disa gjëra i kishte vërtetuar edhe vetë. Për disa i kishte treguar edhe asaj, duke shtuar se nuk dëshironte ta shihte në shoqëri me të. Kur i kishte tërhequr vërejtjen për këtë, i kishte thënë edhe atë urtinë popullore: «Më trego me kë rri, të të tregoj kush je». Vërtet, ky nuk e kishte atë bindje. Në mes tyre shihte ndryshime të mëdha. Megjithatë, shoqërimi me Monën e pengonte. Ndoshta më shumë edhe për shkak të rrethit. Njerëzit, si njerëzit e rrethit tonë, kishin filluar të flitnin. Fjalët e njerëzve nuk mund t'ia ndërronin mendjen, por as nuk e linin të qetë.

— Nuk janë të vërteta të gjitha ato që fliten për të, — i kishte thënë ajo.

— Megjithatë shumë gjëra janë të vërteta, — kishte thënë ky. Sërisht i kishte përmendur disa nga ato për të cilat i kishte treguar edhe më parë. I kishte treguar edhe për disa të tjera. Ajo nuk kishte ditur çka të thoshte. T'i mohonte, nuk mundte.

— Por e ka një cilësi të mirë, — thuase ishte përpjekur të arsyetonte ajo.

— Cilën? — ishte interesuar ky.

— Nuk bën fjalë si disa të tjera.

Ky kishte qeshur. Ishte një e qeshje ironike. Mu për këtë atij nuk i pëlgente Mona. Si nuk e kishte hetuar gjer tanë kjo këtë dobësi të saj! Kishte kthyer kokën dhe e kishte shikuar me habi.

— Pse po më shikon ashtu? — e kishte pyetur ajo. — Nuk po më beson?!

— Përpiku t'i njohësh njerëzit më mirë. Më duket se atë nuk e njeh sa duhet.

— E njoh shumë mirë.

— Sikur ta njihje, nuk do ta thoshe atë që the, — kishte thënë ky dhe kishte shtuar se ajo i përngjante një gjarpri, që thimthim e nxjerr vetëm kur kafshon. Me këtë krahasim i ishte dukur se nuk kishte thënë mjaft dhe kishte shtuar se ajo hynte në grupin e atyre njerëzve që gjithmonë gjuajnë gurin dhe fshehin dorën.

— Nuk është mirë të flasësh për të ashtu, — i kishte tërhequr ajo vërejtjen.

— Nuk ka qenë mirë as për atë të flasë për mua dhe për ty!

— Çka ka folur për mua? — ishte bërë kureshtare ajo.

— Shumë gjëra, — kishte thënë ky dhe nuk kishte dashur ta vazhdonte bisedën. Ajo ishte bërë edhe më kureshtare. Kishte kërkuar t'ia tregonte, por ai kishte heshtur. I kishte propozuar të dilnin në qytet dhe të shikonte në një dyqan që të blinin diçka. Ajo kishte pranuar, por përsëri kishte kërkuar t'i tregonte se çka kishte folur vërtet Mona pér të. Ky kishte bërë sikur nuk ia vinte veshin aq shumë asaj kërkese.

— Trillime qenkan, pra! — kishte thënë ajo dikur.

— Nuk janë, — kishte thënë ky prerë.

— Atëherë pse nuk më tregon?

Ky e kishte shikuar edhe një herë, ndërsa po ec-nin. Kishte vendosur të mos i tregonte pér dy arsyen. Pse të bënte fjalë dhe pse ta shqetëson me gjëra që do të duhej t'i harronte. Por, ja që e kishte filluar bisedën dhe duhej ta conte gjer në fund. Kur ajo kishte ngulur këmbë përsëri t'i tregonte, ky i kishte përmendur se prej saj kishte dëgjuar pér atë që këtë e shqetëson më së shumti sa herë i kujtohej.

— Nuk ke pasur nevojë të pyesësh askend pér mua. Të kam treguar vetë çka është dashur të tregohet.

— As që kam pyetur kend, — ishte betuar ky.

— Ti nuk flet me të, — kishte thënë ajo pas pak, e bindur se ky mund ta kishte provokuar. Ky vërtet e kishte provokuar disa herë. Kjo e bënte ner-voze. Ngjante madje që edhe kur tallej pér ndonjë gjë, ajo ta merrte si provokim.

— Të m'i thoshte mua, më mirë do të bënte.

Kjo e kishte kuptuar se kishte dëgjuar nga të tjerët. Fjalë njerëzish që hanë bukën e vet dhe baj-

në dertin e huaj, kishte menduar dhe ishte habitur se si kësaj radhe këtij i kishin bërë aq përshtypje. Por, kur ky ia kishte përmendur me emër e mbiemër njeriun që ia kishte thënë këto, tek i cili kishte besim se i thoshte të vërtetët dhe me të cilin edhe ajo e dinte se Mona rrinte në shoqëri nganjëherë, ajo kishte lëvizur kokën në shenjë habie. Nuk kishte ditur çka të thoshte. E kishte lëvizur edhe një herë kokën dhe kishte thënë shkurt:

— Mundet.

— Jo mundet, por e vërtetë, — kishte shtuar ky i bindur.

Të gjitha këto i ishin kujtuar, ndërsa kishte ngritur gotën e pestë apo të gjashtë të rakisë së rrushit. Veseli kishte vazhduar të bisedonte me atë, njeriun e karriges fqinje. Dikur i ishte drejtuar:

— Po bie shi i madh.

— Urdhëro! — kishte thënë ky, sikur të ishte zgjuar nga gjumi.

— Duket se nuk e kishe mendjen këtu.

— Po mendoja se çfarë kënaqësie ndiejnë ata njerëz që hanë bukën e vet dhe bajnë dertin e huaj, — kishte thënë me një ton që Veselit i ishte dukur ironizues.

Dhe vërtet kishte ironizuar. Në këtë mënyrë kishte menduar se do t'i thoshte më së miri çka i duhej atij dhe tjetrit të përzihej në punët e tyre.

— Ndoshta nuk bëra mirë që ta thashë atë pak më parë!

— Duhej të ma thoshe atë që mendoje: unë nuk jam pér të, — nuk i ishte duruar pa ia thënë.

— Atë që mendoj edhe ta thashë, — kishte thënë Veseli dhe kishte filluar ta lavdëronte këtë.

— Unë gëzohem kur motra ime gjen një njeri, të cilin e çmoj aq, sa pothuase më çmon ti mua, — kishte folur ky, kësaj radhe me një ironi të theksuar. Ia kishte kujtar se me një rast i kishte thënë se e donte si motër e jo si ilake.

Shiu kishte pushuar. Kur kishin dalë nga restoranti, ishin ndarë. Bisedën me Veselin nuk kishte mundur ta harronte për shumë kohë.

Kjo e kishte shqetësuar edhe më shumë. Edhe pse nuk besonte, i ishte dukur e qëlluar ajo urtia popullore: «Ruajna zot prej miqve, se prej armiqve ruhemë vetë». Me këtë populli kishte shprehur një të vërtetë të hidhur në saje të përvojës së gjatë. Bisedat e mëparshme me Veselin e kishin shqetësuar për një kohë të gjatë. I ishin kujtar të gjitha, prej ditës së parë kur e kishte njojur e gjer tek ajo e fundit në restorant. Kishte analizuar më gjerësisht edhe disa sjellje të tij, që në fillim i ishin dukur të dyshimta, por më vonë nuk kishte dashur t'i besonte vetes. Tani të thuash se çdo gjë e kishte të qartë, prandaj as nuk i kishin bërë përshtypje të gjitha ato që kishte dëgjuar nga të tjerët, që nuk kishin të bënin me të vërtetën. E dinte se disa sosh kishin dalë prej gojës së Veselit, disa të tjera i kishte thënë Mona e më shumë të tjera nga disa që ky i kishte quajtur shokë dhe me të cilët mund të kishte biseduar ndonjë gjë. Edhe ato që mund t'i kishte thënë ky me ndonjë rast, me tallje apo edhe seriozisht, ishin zmadhuar aq shumë, sa nuk kishin të bënin fare me të vërtetën. Të gjitha këto, e dinte mirë, do të shpreheshin negativisht në marrëdhëniec e këtij me atë. Ata që kishin folur për atë do të kënë folur edhe për këtë. Do të jetë gjetur ndo-

një që ia ka thënë asaj se e ka parë këtu ose aty me këtë apo me atë, se ka thënë këtë apo atë e kushedi çka kanë mundur të shpifin. Që kjo ishte kështu, ishte bindur kur e kishte takuar në rrugë në të kthyer nga puna.

— Nuk po bën mirë që po më ndal në rrugë, — i kishte thënë ajo.

T'ia kishte thënë këtë më parë, nuk do të habitej aq shumë, por, që t'ia thoshte pas sa kohësh, madje kur e takonte në rrugë kushedi për të satën herë! As vetë nuk kishte ditur çka t'i thoshte.

— Ndoshfa po të çudit kjo sjellje imja, po çka t'i bësh rrrethit, — kishte thënë ajo dhe pas pëk kishte shtuar: — Kanë filluar të flasin shumë për ne.

Këtë disi e kishte pritur pas asaj bisedës së gjatë, ndërsa po shikonin vitrinat e dyqaneve. Ajo donte të blinte diçka e nuk mund të vendoste kurssesi. Ky i kishte thënë diçka, e ajo ishte hidhëruar shumë. Për gjëra të imta, pa kurrfarë rëndësie, kohët e fundit hidhërohej lehtë. Kështu, e dinte ky nga leximi, veprojnë njerëzit që duken sikur kanë besim të tepruar në vete e që në të vërtetë janë të kundërt, për të cilët përdoret një term i caktuar shkencor që nuk i kujtohej. Me të tillët njeriu duhet të jetë shumë i kujdeshshëm, edhe i durueshëm. Ky nuk kishte mundur të ishte gjithherë i tillë. Prandaj, edhe të thuash se përgjigjen e kishte të gatshme:

— Nëse fjalët e njerëzve të interesojnë më shumë se unë, vërtet nuk kemi çka të bisedojmë më gjatë. — Ia kishte thënë këtë pas disa netvë pa gjumë, kur ishte bindur se shumë prej atyre që kishte dëgjuar ishin shpifje.

— Megjithatë njeriu nuk mund të jetë moskokëçarës, — kishte thënë ajo pas paq. — Prano se ato të bëjnë përshtypje edhe ty.

— Vërtet më bëjnë përshtypje, po nuk ma ndërrrojnë mendjen, — kishte thënë ky.

Ajo kishte buzëqeshur dhe, pasi e kishte përshëndetur, kishte vazhduar rrugën. Ishte hera e parë që ndaheshin në këtë mënyrë. Kjo i kishte dhënë të kuptonte këtij se puna nuk ishte ashtu siç i ishte dukur në shikim të parë. Sjelljet e saj kishin ndryshuar rrënjosht. Iu bë e qartë se vërtet nuk ishte dashur të qëndronte aq mospërfillës ndaj fjalëve të njerëzve. Do të kishte qenë dashur që të përpiqej pér ta përgënjeshtuar posa të kishte dëgjuar diçka që flitej pér këtë. Koha do t'i përgënjeshtronte të gjitha, kishte menduar atëherë, po tanishte bindur se kishte gabuar. Gabimet mund të përmirësohen nganjëherë, po të gjitha kushtojnë. E ky gabim duket se do t'i kushtonte shtrenjtë kësaj rade. Ishte përpjekur ta përmirësonte disi. Mënyra më e mirë i ishte dukur ta fillonte përséri bisedën pér dashurinë, me ta takuar. I dukej se do të ishte vështirë, pas atij largimit të saj në atë mënyrë, që ta nxitte të bisedonin pérëri, së paku brenda një kohe të shkurtër. Dhe një ditë, pér habi të këtij, ajo kishte ndaluar vetë. Kishin shkuar në park dhe kishin biseduar gjatë.

— Të dashurosh dikë, do të thotë të vuash pér atë, — i kishte thënë ky një mendim që e kishte lexuar para disa ditësh në një revistë të ilustruar.

— Mund të jetë ashtu, — kishte thënë ajo. Këtij i ishte dukur se nuk i kishte besuar. Ndoshata nuk kishte bërë mirë që ia kishte përmendur se atë e

kishte lexuar. Do të duhej t'ia kishte thënë se po fliste nga ndjenjat e tij. Por, prej ditës kur ajo kishte filluar t'i rrëfehej, ky kishte formuar bindje se me të do të duhej të ishte i singertë. Madje, as nuk kishte përdorur në bisedë me të lajkat e komplimentet që, në të shumtën e rasteve, i kanë qejf femrat. Gjithmonë kishte biseduar shtruar. Edhe me këtë mund të kishte gabuar. Çka do t'i kishin kushtuar dy-tri fjalë të mira, dy-tri komplimente? Mund t'i kishte recitar dhe ndonjë poezi erotike nga gjithë ato që dinte përmendsh. Sikur të vepronte kështu, nuk do t'i përgjigjej aq ftohtë. Pas kësaj përgjigjeje nuk dinte çka t'i thoshte. Si ta vazhdonte bisedën.

— Nuk beson, — kishte thënë pas pak.

— Po flet me libra, — kishte thënë ajo, e ky e kishte kuptuar se i ishte përgjigjur me ironi.

Pas kësaj kishte ndërruar bisedë. As vetë nuk e dinte më se për çka i kishte folur. Kishte kaluar prej një teme në tjetrën, pa lidhje. Asnjëherë nuk kishte vepruar në këtë mënyrë. Më kot ishte përpjekur të gjente temën që do të mund t'i interesonte edhe asaj. Ky i fliste, e ajo vetëm e shikonate. Rrallë i shkonte buza në gaz. Nuk e dinte as pse qështë. Këtij i ishte mbushur mendja se kësaj radhë do të duhej t'ia thoshte atë për të cilën kishte menduar më parë. Kur i kishte lindur ky mendim në kokë, kishte bërë edhe planin se si do t'ia thoshte. Biseda nuk kishte shkuar ashtu si e kishte paramenduar ky.

— Për atë që dashuron duhet të sakrifikosh diçka tenden, — i kishte thënë ky dhe ishte skuqur. Nuk e dinte pse. I ishte dukur se e kishte thënë

krejt pa lidhje, si mendim që i kishte ardhur aty pér aty, pa e menduar gjatë.

— Mendim i mirë. Ku e ke lexuar?

Më kot ishte përpjekur ta bindte se nuk i kujtohej ku e kishte lexuar. I kishte thënë mandej se nuk kishte rëndësi ku e kishte lexuar e as kush e kishte thënë, po se ishte mendim i qëlluar, të cilin nuk duhej ta harronin njerëzit.

— Çka sakrifikove ti pér mua? — e kishte pyetur ajo. Me këtë donte t'i thoshte se ky nuk e donte atë. Vërtet, edhe ia kishte thënë disa herë. Tani do të duhej t'ia thoshte gjithë ato që ky i quante si sakrifica, po nuk e kishte pér zakon t'ia përmendte. Edhe pse i dukej se kishte bërë mjaff pér të, nuk i tha asgjë. Vetëm rrudhi krahët dhe heشتی.

Asaj, ndoshta, i ishte mbushur mendja se e kishte zënë ngushtë. Pse nuk i përmendte vetëm njérën? Ndoshta do të kishte shërbyer pér të vazduar bisedën. E ky nuk i kishte thënë asgjë. Edhe ajo kishte lidhur kast të mos fliste. Më vonë, kur ky e kishte provokuar diçka, ajo, disi me ironi, tha prerë:

— Unë nuk kam lindur të dashuroj dikë, vetëm të më dashurojnë.

— Të tillët janë me fatkëqinjtë, — i kishte thënë ky pa menduar shumë nëse ajo, kishte folur seriozisht apo vetëm ishte tallur. Në atë çast i ishte dukur se kohët e fundit ajo kishte filluar ta mbante veten disi më lart se më parë. Ndoshta edhe ajo donte të provonte diçka te ky, ashtu si kishte vepruar edhe ky në disa raste. Mund të

kishin ndikuar fjalët e njerëzve edhe në qëndrimin e saj.

— E di, — kishte thënë ajo përsëri prerë dhe ky ishte habitur me këtë përgjigje. Si është e mundur të jetë e vetëdijshme se diçka nuk është mirë dhe të mos përpinqet ta largojoë? Kështu mund të veprojnë vetëm ata që mendojnë se e thyenjë murin me kokë. Vallë, mos ishte edhe kjo e tillë? Nuk dëshironte t'i besonte këtij dyshimi, qoftë edhe i rastit. Do të ndryshojet me kohë. Dikur mund të jetë vonë, por edhe ky i ishte dukur mendim i paqëlluar. Më mirë vonë se hiç.

Kur ishin ndarë, në qytet, ajo i kishte thënë disa fjalë që i kishte dëgjuar nga të tjerët. Ishin trillime pa skrupuj. Ishte përpjekur ta bindte se nuk ishte mirë të fliste me fjalët e gojëkëqinjve, që nuk ia donin të mirën as asaj e as këtij. Ajo të gjitha i kishte marrë për të vërteta. Së paku, kështu iu duk këtij sipas tonit me të cilin ia tha. Pasi iu duk se kot përpinqej ta bindte se të gjitha ato ishin fjalë njerëzish, vendosi të mos e zgjaste bisedën më. Do ta shihte edhe ajo vetë se kishte gabuar.

Kishin kaluar disa kohë dhe nuk e kishte takuar. Në fillim vetë i ishte larguar takimit me të. Mirëpo një ditë, kur kishte dalë ta takonte në kohën e caktuar dhe në vendin ku e talkonte shpesh, ajo nuk kishte ardhur fare. Vërtet, njerëzit kishin vazhduar akoma t'i flitnin për të, t'i thoshin gjëra të reja, po ky nuk ua vinte veshin. Megjithatë, kur nuk e kishte takuar edhe disa herë të tjera, aty ku e takonte më parë, kishte filluar të dyshonte se ndoshta kësaj radhe ajo që flite mund të

ishte e vërtetë. Nuk kishte dashur ta besonte. Një-farë krenarie, që arrinte deri në kokëfortësi, nuk e kishte lejuar të shkonte gjer në vendin e saj të punës dhe të mësonte të vërtetën. Më mirë, kishte menduar, ta takonte gjoja rastësisht.

Dhe vërtet, pas ca kohësh e kishte takuar rastësisht, por kësaj radhe jo aty ku e kishte takuar më parë. Me disa shokë, një mbrëmje, po rrinte në njérën nga kafe-baret e qytetit. Më vonë kishte hyrë edhe ajo me njërim, të cilin ky nuk e njihet. Kur e kishte parë, ishte skuqur. Ishte skuqur edhe ky. Dikush nga shokët kishte thënë se ai ishte një shok i Monës. Tjetri kishte shtuar se këta ishin fejuar.


- Ka qenë vajzë e mirë, — kishte thënë njëri.
- Është, — e kishte përmirësuar ky.
- Një kohë ishte me ty.
- Shoqërohej, — kishte thënë ky prerë.
- Kisha bindje se e ke dashur dhe të ka dashur.
- Ndoshtha, — kishte thënë ky. I ishin kujtuar disa raste martesash të njerëzve që nuk e kishin njohur mirë njëri-tjetrin. Disa të tillë kalonin jetë të lumtur bashkëshortore, kurse të tjerët, ata që nuk kishin gjetur te njëri-tjetri atë që kishin kërkuar, nuk e kishin zgjatur shumë.
- Kështu e ka kjo jetë, — kishte thënë shoku.
- Jetën e bëjnë njerëzit, — kishte thënë ky dhe nuk kishte dashur ta vazhdonte bisedën për të. Edhe vetë ishte bindur se nuk kishte shprehur atë që kishte menduar të thoshtë. Kishte filluar

të fliste për diçka tjetër, që as këtij nuk i interesonte tani për tani.

Të gjitha këto iu kujtuan ndërsa po shikonte fotografinë në faqen e parë të revistës së ilustruar. Dhoma ishte mbushur me tym. Në taketuke xixëllonin disa duqe cigaresh. Duket se pa e mbaruar njëren kishte ndezur tjetrën. I fiku duqet dhe hapi dritarë. Tymi i dendur shpërndahej në hapësirën e gjerë dhe zhdukej menjëherë. E shikoi edhe një herë fotografinë dhe buzëqeshjen sa të sinqertë aq edhe naivë të vajzës. Iu kujtuan përsëri fotoreporteri dhe redaktori i revistës. Iu kujtuan edhe të gjithë njerëzit me të cilët kishte biseduar për të. E la atë mënjanë dhe filloi të shfletonte numrat e tjerë të asaj reviste. As vetë nuk e dinte se çka kërkonte: poezitë e veta të botuara kur ishte djalosh, apo frymëzime për punime të reja?

## PËRMBAJTJA

|                              |    |
|------------------------------|----|
| Ai ishte nxënësi i tij ..... | 5  |
| Ndryshimi .....              | 13 |
| Shenjë në lis .....          | 19 |
| Endrra .....                 | 25 |
| Shpërblimi .....             | 33 |
| Përcjellja .....             | 39 |
| Kthimi .....                 | 46 |
| Premtimi .....               | 53 |
| Vajza e faqes së parë .....  | 58 |



Jasiqi, A. D.

Shënjë në Lis. Tregime. [Red. I. Haxhimihali]. T., «Naim Frashëri», 1980.

96 f.

(B.m.) dhe

(B.v.) : 891, 983-32

Tirazhi 6000      kopje Formati 70x100/32      Stazh: 2204-79

KOMBINATI POLIGRAFIK Shtypshkronja e Re  
Tiranë, 1980